Java e pestë:	Plazma dhe proteinat e plazmes se gjakut
Java e gjashtë:	Lengjet trupore, elektrolitet dhe bilanci acidobazik
Java e shtatë:	Materjet minerale ne gjak dhe lengje trupore <i>Vlerësimi i parë intermediar</i>
Java e tetë:	Clinical chemistry of common domestic species
Java e nëntë:	Nitrogjen supstancat (substancat azotike)
Java e dhjetë:	Karbohidratet e lengjeve trupore dhe metabolizmi i tyre
Java e njëmbëdhjetë:	Endokrinologjia klinike e riprodhimit
Java e dymbëdhjetë:	Vitaminat, roli dhe karakteristikat e tyre ne biokimine klinike Veterinare
Java e trembëdhjetë:	Tumor markeret
Java e katërmëdhjetë:	Biokimia klinike e shpezeve
Java e pesëmbëdhjetë:	Biokimia klinike e gjitareve <i>Vlerësimi i dytë intermediar.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit: Ushtrimet	
Java	
Java e parë:	Llojet e laboratoreve dhe rregullat laboratorike ne Biokimin klinike Veterinare
Java e dytë:	Paisjet laboratorike ne laboratorin e Biokimise klinike Veterinare
Java e tretë:	Laboratori, njohurit e zonoozave dhe kujdesi ndaj tyre
Java e katërt:	Llojet e mostrave dhe karakteristikat e tyre

<i>Java e pestë:</i>	Marja e mostr dhe teknikat e ngjyrosjaes se gjakut - Wright-Giemsa
<i>Java e gjashtë:</i>	Numrimi dhe identifikimi i rruzave te bardha te gjakut, te llojet e ndryshme te kafshet e ndryshme
<i>Java e shtatë:</i>	Hemoglobina, Hematokriti dhe Hemoglobin, Hematocrit, Hematocitometria.
<i>Java e tetë:</i>	Testi i kuagulimit te gjakut dhe karakteristikat e tij.
<i>Java e nëntë:</i>	Enzimat e gjakut dhe testet e tyre.
<i>Java e dhjetë:</i>	Testet Antigjen - Antitrupe
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Analizate Urines (Mbledhja e mostrave)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Analizat e urines (Karakteristikat fiziki-kimike te urines)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Testet e urines (Perbersit kimik dhe egzaminimi mikrobiologjik i urines)
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Testet e koprokultures ne kafsh
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testet e lengjeve sinoviale dhe cerebrospinale ne kafshe.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Biokimia Mjekësore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Assoc. Valdete Topçiu
Detajet kontaktuese:	valdete.topciu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Biokimia mjekësore është disiplinë mjekësore e cila hulumton kompleksitetin e reaksioneve kimike në qelizat e njeriut të cilat mundësojnë realizimin e proceseve fiziologjike në trupin e njeriut. Përmes këtyre njohurive janë krijuar teknikat biokimike të cilat shërbejnë për të përcaktuar parametrat e gjendjes të shëndoshë dhe sëmundjeve
Qëllimet e lëndës:	<p>-Biokimia mjekësore ka për qëllim të ofrojë njohuritë të cilat sqarojnë ndodhitë në mjedisin brendaqelizor në nivelin molekular.</p> <p>-Njohjen strukturës dhe funksionit të molekulave të prodhuara nga qelizat e njeriut</p> <p>-Njohja e parametrave homeostatik përmes të cilëve përcillet gjendja e shëndoshë dhe sëmundjet</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>-Njohja e proceseve biokimike në qelizat e njeriut</p> <p>-Fitimi i njohurive rreth interaksionit të sinjaleve të ndryshme molekulare të cilat e promovojnë proceset fiziologjike.</p> <p>-Ndikimi i rolit të strukturës dhe funksionit të substancave qelizore në zbatimin e teknikave në biokimi mjekësore</p>
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata			
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:			
	<p>-Përdorimi i ligjeratave përmes sllajdeve -Mësimi interaktiv me studentët -Diskutimi përmes pyetjeve analitike -Prezentimi me seminare</p> <p>Mjetet: Librat referentë, punimet shkencore, projektori, modelet anatomike, tabela</p>		
Metodat e vlerësimit:			
	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes analizës të angazhimit gjatë tërë semestrit/vitit akademik. Dy teste do të vlerësojnë njohuritë nga lëmia, ndërsa aktiviteti në vlerësimin përfundimtar do të përfshihet edhe aktiviteti në ligjerata dhe ushtrime.</p> <p>Sistemi i vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Testet 70% 2. Seminaret dhe angazhimi në ligjerata 20% 3. Angazhimi në ushtrime 5% 4. Vijueshmëria 5% 		
Literatura			
Literatura bazë:	Lehninger Principles of Biochemistry. DL Nelson, MM Cox.		
Literatura shtesë:	Punimet shkencore në revistat ndërkombëtare nga lëmia e biokimisë mjekësore.		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Biokimi Mjekësore
<i>Java e dytë:</i>	Struktura e proteinave (aminoacidet, peptidet)
<i>Java e tretë:</i>	Struktura e proteinave (struktura primare, sekondare, terciare dhe kuaternare e proteinave)
<i>Java e katërt:</i>	Funksioni i proteinave
<i>Java e pestë:</i>	Proteinat globulare, fibrilare, enzimet, koenzimet
<i>Java e gjashtë:</i>	Komponentat biokimike të qelizave, membrana qelizore
<i>Java e shtatë:</i>	Metabolizmi, enzimet digjестive
<i>Java e tetë:</i>	Metabolizmi i karbohidrateve
<i>Java e nëntë:</i>	Metabolizmi i lipideve
<i>Java e dhjetë:</i>	Metabolizmi i acideve nukleike
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Metabolizmi i proteinave, vitaminat
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Hormonet, mineralet dhe metabolizmi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Biokimia e gjakut
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sëmundjet metabolike
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> -Përcjellja e rregullt e ligjeratave dhe ushtrimeve -Angazhimi aktiv në ligjerata dhe ushtrime -Përgaditja e seminareve dhe detyrave tjera -Pjesëmarrja në testim -Respektimi i rregullave të mirësjelljes (qetësia, ruajtja e pajisjeve, kthimi i pajisjeve, largimi nga salla me leje) -Ndalohet praktika e plagjiaturës

SYLLABUS për lëndën: Biologji e qelizës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës „ Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Drejtimi: Biologji
Titulli i lëndës:	Biologji e qelizës
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i parë , semestri i parë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Amfiteatri në Depart. e Fizikës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Kasum Letaj
Detajet kontaktuese:	kasum.letaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Në këtë lëndë përshkruhen: qeliza, strukturat qelizore, organizimi dhe mekanizmat molekular të funksionimit të organeleve qelizore si dhe mekanizmat e rregullimit të ciklit qelizor. Po ashtu përshkruhet struktura e ndërtimit të katër indeve bazë të organizmave shtazorë: epitelial, lidhor, muskolor dhe nervor.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është që studenti gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve të i zgjeroj njohurit mbi qelizën, strukturat qelizore, organizimin molekular dhe funksionin e organeleve qelizore. Po ashtu, studentit i mundësohet të njihet me strukturën e ndërtimit të katër indeve bazë të organizmave shtazorë: epitelial, lidhor, muskolor dhe nervor.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që te: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj strukturën dhe funksionin e qelizës dhe organeleve qelizore si dhe organizimin themelor të kromatinës. • Shpjegon dallimet në mes tipeve të ndryshme të qelizave dhe indeve shtazore • Hulumton me mikroskop optik në qeliza dhe inde shtazore. • Dallon ultrastrukturën e organeleve qelizore në bazë të mikrofotografive nga mikroskopi elektronik (të njeh

	strukturën ndërtimore). <ul style="list-style-type: none"> Vlerëson hulumtimet në nivel të qelizave dhe indeve. 		
Kontributi ne ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	6/semestër	-	6
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	4/semestër	-	4
Detyra të shtëpisë	6/semestër	-	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	6/semestër	-	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4/semestër	-	4
Projektet,prezantimet ,etj	4/semestër	-	4
Totali			150 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërime nga materiali i përgatitur më parë Diskutime Punë praktike (mikroskopim dhe skematizim) Punë seminarike		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi përfundimtar paraqet shumën: E punës së suksesshme praktike: 25% Vlerësimit të parë intermedier; 15% Vlerësimit të dytë intermedier:20% Vijimit të rregullt dhe angazhimit në diskutime dhe seminare 10% Provimit final me test ose me gojë: 30% Totali: 100 %		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Elezaj, R.I., Letaj, Rr. K.(2012): Biologjia qelizore. Universiteti I Prishtinës. Prishtinë.		

Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rexha, T. (2012): Biologjia qelizore dhe molekulare, Shtëpia botuese “Mediaprint”, Tiranë. 2. Alberts, B., Bray, D., Jonson, A., Lewis, J., Raff, M., Roberts, K., Walter, P. (1997): Essential Cell Biology, New York. 3. Alberts, B., Bray, D., Jonson, A., Lewis, J., Raff, M., Roberts, Watson, J. (2016): Molekular Biology of THE CELL. Sixth edition, New York & London. 4. Elsa, K., Çaço, B., Çeka, Xh. (2002): Bazat e histologjisë dhe embriologjisë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Natyra e gjallë dhe vetit e saja Dallimi në mes qelizave prokariote dhe eukariote Virusët Rikeciet Mikoplazmat Bakteret Karakteristikat e përgjithshme të qelizës
Java e dytë:	Membrana qelizore Përbërja kimike Lipidet membranore Proteinat membranore Karbohidratet membranore
Java e tretë:	Lidhjet qelizore Zona occludens Zona adherens Dezmozomet Hemidezmozomet Lidhjet komunikuese
Java e katërt:	Qarkullimi i materieve nëpër plazmolemë Transporti i molekulave të vogla dhe joneve Difuzioni i thjeshtë Transporti pasiv (difuzioni i lehtësuar) Transporti aktiv Kanalet proteinore Kanalet ujore Kanalet jonike Bartësit proteinor Pompa e Natrium - Kaliumit Jonoforet

	Transporti i makrromolekulave Endocitoza Ekzocitoza Transporti transcelular
Java e pestë:	Citosoli Vetit e përgjithshme dhe përmbajtja e citosolit Përbërësit specifik të qelizës Glukogjeni Pikëzat e yndyrës Pigmentet
Java e gjashtë:	Bërthama Mbështjellësi bërthamor Laminat bërthamore Kromatina dhe kromozomet Bërthamëza
Java e shtatë:	Organelet e citosolit Ribozomet Organelet membranore Retikulumi endoplazmatik Kompleksi i Golxhit Endozomet Lizozomet
	Vlerësimi i parë intermrdier
Java e tetë:	Peroksizomet Mitokondritë Kloroplastet
Java e nëntë:	Citoskeleti Filamentet e ndërmjetme Mikrrogypat Qendrozomi Centriolet Ciliet Aktina dhe filamentet e aktinës Mikrovoilet
Java e dhjetë:	Ndarja qelizore Cikli qelizor Mitoza Mejoza
Java e njëmbëdhjetë:	Kontrolli i ciklit qelizor Rritja dhe vdekja Kanceri
	Vlerësimi i dytë intermrdier
Java e dymbëdhjetë:	Histologji e përgjithshme Indi epitelial Klasifikimi i epitelit mbulues

	Klasifikimi i gjëndrave
Java e trembëdhjetë:	Indi lidhor Klasifikimi i indit lidhor
Java e katërbëdhjetë:	Indi muskolor Muskulatura e lëmuar Muskulatura tërthorovijore Muskulatura e zemrës
Java e pesëmbëdhjetë:	Indi nervor
Plani i dizajnuar i mësimit– Ushtrimet:	
Nr.	Ushtrimet laboratorike që do të zhvillohen
1.	Mikroskopi dhe mikroskopimi
2.	Qeliza
3.	Membrana qelizore – Modeli “Mozaiko - fluid”
4.	Bërthama dhe pori bërthamor
5.	Retikulumi endoplazmatik dhe mitokondria
6.	Aparati i Golxhit dhe lizozomet
7.	Paraqitja skematike e kromozomit në metafazë dhe centriola
8.	Mitoza dhe mejoza
9.	Indi epitelial
10.	Indi lidhor
11.	Indi kërcor
12.	Indi eshtëror
13.	Elementet e gjakut
14.	Indi muskolor
15.	Indi nervor

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjëratat, ushtrime (pjesën praktike) dhe se punë seminarike

Mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj..

Në mënyrë që ti nënshtrohet vlerësimit të parë dhe të dytë studenti është i obliguar që ti ndjek së paku 70% të ligjeratave.

SYLLABUS për lëndën: Biologji e zhvillimit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës „ Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Drejtimi: Biologji
Titulli i lëndës:	Biologji e zhvillimit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i parë , semestri i dytë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Amfiteatri në Depart. e Fizikës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Kasum Letaj
Detajet kontaktuese:	kasum.letaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Në këtë lëndë përshkruhen: procesi i gametogjenezës, organizimi i vezës, pllenimi dhe stadet e e ndryshme të zhvillimit embrional te amfioksusi, iriqi i detit, amfibet, shpezët dhe gjitarët. Po ashtu sqarohen mekanizmat e organogjenezës si dhe roli i gjeneve në determinimin dhe diferencimin e qelizave. Po ashtu sqarohet procesi i rritja, metamorfozës dhe regjenerimit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është që studenti gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve të thelloj njohurit mbi principet themelore të biologjisë së zhvillimit si dhe të kuptoj mekanizmat molekularë të proceseve të cilat e mundësojnë këtë zhvillim. Vëmendje e posaçme i kushtohet pjesës praktike ku gjatë mikroskopimit do të vrojton dhe kupton procesin e gametogjenezës, fertilizimit si dhe stadet e ndryshme të zhvillimit ontogjenetik .
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan principet themelore të biologjisë së zhvillimit. • Sqaron mekanizmat molekular të proceseve të rëndësishme siç është procesi i diferencimit të indeve (histogjeneza) dhe organeve (organogjeneza). • Demonstron aftësi për interpretim të

	<p>problemeve nga biologjia e zhvillimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon stadet e ndryshme të zhvillimit embrional si në kuadër të llojit ashtu edhe në kuadër të llojeve të ndryshme. • Vlerëson metodat e aplikueshme për hulumtime nga biologjia e zhvillimit. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	6/semestër	-	6
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	4/semestër	-	4
Detyra të shtëpisë	6/semestër	-	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	6/semestër	-	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	4/semestër	-	4
Projektet,prezantimet ,etj	4/semestër	-	4
Totali			150 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërime nga materiali i përgatitur më parë Diskutime Punë praktike (mikroskopim dhe skematizim) Punë seminarike</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi përfundimtar paraqet shumën: E punës së suksesshme praktike: 25% Vlerësimi të parë intermedier; 15% Vlerësimi të dytë intermedier:20% Vijimit të rregullt dhe angazhimit në diskutime dhe seminarë 10% Provimit final me test ose me gojë: 30% Totali: 100 %</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Materiali i përgatitur më parë në formë		

	<p>skripte.</p> <p>2. Rexha, T., Hamzaraj, E., Laknori, O. (2006): Biologjia e zhvillimit. Tiranë.</p>
Literatura shtesë:	<p>1. Gilbert, F. S.(2010): Developmental biology,Nint edition. USA</p> <p>2. Wolpert, L. (1998): Principles of development, London, New York</p> <p>3. Kalthoff, K. (1996) : Analysis of biological development, New York</p> <p>4. Müller, A. W. (1996): Developmental Biology, Haidelberg, Germany</p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në Biologjinë e zhvillimit Organizmi si tërësi Perspektivat historike
Java e dytë:	Gametogjeneza Spermatogjeneza Ndërtimi i spermatozoidit Veçorit biologjike të spermatozoidit Cikli seksual mashkullor
Java e tretë:	Oogjeneza Trupi i verdhë Cikli seksual femëror Fazat e ciklit seksual
Java e katërt:	Organizimi i vezës Organizimi i citoplazmës Vitelinogjeneza Specializimet morfologjike në citoplazmën e oociteve
Java e pestë:	Ekspresioni i gjeneve gjatë oogjenezës Mbështjellësit e qelizës vezë
Java e gjashtë:	Pllenimi (fekondimi) Bashkëveprimi i qelizës vezë dhe spermatozoidit gjatë pllenimit Bashkëveprimi reciprok distant Bashkëveprimi kontaktues Proceset të cilat rrjedhin pas hyrjes së spermatozoidit në qelizën vezë Segregacioni ooplazmatik Partenogjeneza
Java e shtatë:	Segmentimi Përcaktimi dhe roli biologjik i segmentimit Orientimi hapësinor i segmentimit Ligjeshmërit lidhur me pranin dhe radhitjen e vitelinës Segregacioni ooplazmatik gjatë segmentimit

	Bashkëveprimi kontaktues në mes blastomereve
	Vlerësimi i parë intermedier
Java e tetë:	Morulla dhe Blastulla Tipet e blastullës Aktivizimi i gjenomit të embrionit
Java e nëntë:	Gastrullacioni dhe formimi i fillesave primare të organeve Formimi i mezodermës Gastrullacioni dhe formimi i fillesave primare të organeve të amfioksusi Gastrullacioni dhe formimi i fillesave të organeve të iriçi i detit Gastrullacioni dhe formimi i fillesave të organeve të peshqit
Java e dhjetë:	Gastrullacioni dhe formimi i fillesave të organeve të amfibet Gastrullacioni dhe formimi i fillesave të organeve të shpezët Adaptimet embrionale të reptilët dhe shpezët
Java e njëmbëdhjetë:	Zhvillimi embrional i gjitarëve Organet ekstraembrionale të gjitarët Placentacioni të gjitarët Tipet e placentave Barriera placentave
	Vlerësimi i dytë intermedier
Java e dymbëdhjetë:	Organogjeneza Morfogjeneza Origjina embrionale e organeve Diferencimi citologjik dhe histologjik
Java e trembëdhjetë:	Roli i gjeneve në determinimin dhe diferencimin e qelizave Ekuivalentiteti i gjenomit
Java e katërbëdhjetë:	Rritja
Java e pesëmbëdhjetë:	Metamorfoza Regjenerimi
Plani i dizajnuar i mësimi – Ushtrimet:	
Nr.	Ushtrimet laboratorike që do të zhvillohen
1.	Gametogjeneza
2.	Spermatogjeneza
3.	Folikulogjeneza (Oogjeneza)
4.	Zhvillimi embrional i iriçi të detit (Paracetrotus lividus)
5.	Zhvillimi embrional i amfioksusit- (Amphioxus lanceolatus) - segmentimi , blastulla -
6.	Zhvillimi embrional i amfioksusit (Amphioxus lanceolatus) - gastrulimi
7.	Zhvillimi embrional i ujëtoksoreve (Amphibia)- segmentimi , blastulla
8.	Zhvillimi embrional i ujëtoksoreve (Amphibia)- gastrulimi
9.	Zhvillimi embrional i shpezëve (Aves)-segmentimi, blastulla
10.	Zhvillimi embrional i shpezëve (Aves)-gastrulacioni
11.	Zhvillimi embrional i shpezëve (Aves)-gastrulacioni

12.	Zhvillimi embrional i shpezëve (Aves)-formimi i organeve ekstraembrionale dhe hapësirës amniotike
13	Zhvillimi embrional i shpezëve (Aves)-Zhvillimi i embrionit të zogut të pulës brenda gëzhojës
14	Zhvillimi embrional i gjitarëve (Mammalia)-segmentimi , blastulacioni
15	Zhvillimi embrional i gjitarëve (Mammalia)-formimi i organeve ekstraembrionale
	Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
	<p>Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe se punë seminarike</p> <p>Mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj..</p> <p>Në mënyrë që ti nënshtrohet vlerësimit të parë dhe të dytë studenti është i obliguar që ti ndjek së paku 70% të ligjeratave.</p>

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti i Psikologjisë
Titulli i lëndës:	Biopsikologji
Niveli:	Bachelor i Psikologjise
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Parë (1)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Ilir Mazreku
Detajet kontaktuese:	+38344361785, ilir.mazreku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Biopsikologjia si ndërdisiplinë shkencore merret me studimin e pjesës së gjallë të organizmit dhe ndërlidhjen më pjesën kognitive dhe sjelljore. Që nga ndërtimi i një qelize deri tek neurokimia e neuroneve, gjenetika, hormone dhe efektet e tyre, si dhe çrregullimet e ndryshme që vijnë si pasojë e ndryshimeve të strukturave të ndryshme biologjike janë pjesë e studimit të kësaj discipline. Gjatë këtij kursi do provohet që studentëve të Departamentit të Psikologjisë të ju zhvillohet një perspektivë biologjike për proceset psikoke që janë pjesë e profesionit të tyre.
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Objektivat</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Të njoh biologjinë e sjelljes, strukturat, funksionet dhe çrregullimet kryesore • zhvilloj dhe thelloj njohuritë për neuroanatomia funksionale të sistemit nervor, neurofiziologjisë, gjenerimit, transmissiionit dhe integritetit të sinjaleve nervore dhe neurokimisë së tyre • fitoj njohuri bazë për implikimin e trashëgimisë dhe biologjinë e proceseve kryesore psikologjike, ndijim, perceptim, menduarit, memoria, vetedija dhe të mesuarit
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - shpjegoj ndërtimin dhe funksionin e sistemit nervor qendror dhe periferik dhe format e ndryshme të komunikimit qelizor dhe implikimin e neurotransmiterëve në sjellje njerëzore - analizo bazën gjenetike, neurologjike dhe hormonale në rregullimin e sjelljes - kuptoj se hipotalami është urë lidhëse ndërmjet sistemit nervor me sistemin endokrin, neuroendokrin

	<p><i>dhe imun.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>shpjegoj bazën biologjike të ciklit zgjim-gjumë</i> - <i>shpjegoj evolucionin e trurit dhe sjelljen dhe ndërlidhë sëmundjet mentale me motivimin, stresin, emocionet.</i> 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	1	20	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	6	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	15	15
Totali			170
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Ligjerata frontale e kombinuar me diskutime per rastet (nga materiali i përgaditur më parë dhe i cili u shpërndahet studentëve), mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutim etj. Për ilustrim dhe përforcim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhë materiale pamore, si sllajde, figura, skema, programe simuluese kompjuterike të cilat e mbështesin përmbajtjen programore dhe thellojnë njohuritë në kaptinat e veçanta të lëndës. Do të përzgjedhen metoda e strategji të përshtashme të mësimdhënies e mesimnxënies që motivojnë dhe nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të studentit.</i></p>		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>40 %-Vlerësimi i pare intermedier 40 %-Vlerësimi i dytë intermedier 20 %-Vlerësimi në pjesën e ushtrimeve dhe angazhime të tjera, punë seminarike, prezantim, aktivitet në klasë, pjesmarrje në kuize.</i></p>		
Literatura			

Literatura bazë:	1. Biopsychology, John Pinel, Publisher Allyn and Bacon 2011, Boston
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Ligjeratat e pregaditura ne gjuhen shqipe nga ana e profesorit.</i> • <i>Artan Shkoza: Fiziologjia e njeriut, "Ilar" Tirane, 2009.</i>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Historiati, defnimi, fusha e studimit dhe diciplinat kryesore të neuroshkencave, dhe të Biopsikologjisë në veçanti, Baza biologjike e sjelljes.
Java e dytë:	Neuroanatomia funksionale e sistemit nervor
Java e tretë:	Metodat e hulumtimit (rezonanca magnetike, tomografia, manipulimi psikofarmakologjik)
Java e katërt:	Neurofiziologji, gjenerimi, transmisioni dhe integrimi i sinjaleve nervore I.
Java e pestë:	Neurofiziologji, gjenerimi, transmisioni dhe integrimi i sinjaleve nervore II.
Java e gjashtë:	Baza kimike e sjelljes; neurotransmiterët dhe neurofarmakologjia
Java e shtatë:	Ndijimi dhe perceptimi, proceset e përgjithshme ndijore
Java e tetë:	Baza gjenetike e sjelljes
Java e nëntë:	Sistemi endokrin, truri, sjellja
Java e dhjetë:	Biopsikologjia evolutive, evolucioni trurit dhe sjellja
Java e njëmbëdhjetë:	Bioritmologjia, cikli zgjim-gjum baza neurokrine endokrine dhe neuroendokrine.
Java e dymbëdhjetë:	Biopsikologjia e motiveve
Java e trembëdhjetë:	Biopsikologjia e emocioneve, stresi dhe shëndeti
Java e katërmëdhjetë:	Biopsikologjia e çrregullimeve psikiatrike
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësim i prezantimeve të studentëve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p><i>Provimi me final mund të zëvendësohet me kalimin e dy testeve intermediere me shkrim për një semester. Pas testit të dytë intermediar përpilohet lista e studentëve të cilit kanë fituar të drejtë për të marrë notën në SEMS (duke marrë parasysh edhe vlerësimin nga pjesa praktike) si dhe propozohet nota e merituar. Studentet që janë të kënaqur me notën e propozuar, paraqesin provimin dhe konformë orarit të shpallur nga Fakulteti për këtë lëndë u shkruhet nota në SEMS. Studentët të cilit nuk janë të kënaqur me notën e propozuar, kanë të drejtë të i nënshtrohen vlerësimit final në afatin e provimeve. Pikët sipas metodës së vlerësimit që merren nga ushtrimet (20%) i barten studentit për një vit akademik. Pasi të kaloj një vit akademik studentët mund të hynë në provim 100% me test apo sipas kërkeses me komision. Studentët që shkelin rregullat e mësimit apo të mbajtjes së vlerësimit, kopjojnë, mbajnë pajisje të</i></p>

menqura me vete gjatë testit (smartphone, tablet, etj), prishin rendin, nuk dorëzojnë testin në kohën e paraparë dhe treguar nga profesori, ndryshojnë vendet në klasë pa leje automatikisht e humbin të drejtën e vlerësimit me test, ata duhet t'i nënshtrohen vlerësimit tradicional-me gojë në afatin vijues dhe do të delegohen për në komisionin dicitlinor të fakultetit.

Studentet vlerësohen në bazë të kualitetit (e jo sasisë) dhe korrektësisë gjatë përgjigjes në pyetsorë, logjikës dhe shkathtësisë për të ndërlidhë relacionet shkak-efekt dhe shkak-pasojë në neuropsikologji.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN, Dep.Biologjisë
Titulli i lëndës:	Biostatistika
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Parë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Amfiteatri i Fizikës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Ilir Mazreku
Detajet kontaktuese:	044361785, ilir.mazreku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Biostatistika (ose biometria) është disipline shkencore që merret të kuptuarit, të përshkruarit, të sistemuarit, të analizuarit saktë dhe të interpretuarit drejt të ndryshueshmërisë në biologji, të interpretuarit e eksperimenteve në bujqësi, ose në përgjithësi në shkencat biologjike. Pra, studimi i biostatistikës e ndihmon biologun, ekologun, agronomin, inxhinierin e pyjeve apo të agromjedisit, zooteknikun, seleksionuesin e bimëve dhe të kafshëve, gjenetistin, sistematizuesin, mjekun, zooveterinerin etj., që të kuptoj në radhë të parë natyrën e ndryshueshmërisë në biologji. Përmbajtja e lëndës përfshin: hyrje në biostatistikë, organizimi dhe fazat e hulumtimit statistikor, probabiliteti, kombinatorika, grafikët, pjesa përshkruese e biostatistikës, kontrolli i hipotezave, analiza e variancës (ANOVA), t- testi, korrelacioni dhe regresioni.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none">• <i>Studentët të fitojnë njohuri bazike biostatistikore dhe shfrytëzimin e tyre në praktikë gjatë punës së tyre hulumtuese në fushën e biologjisë.</i>• Të dinë të përdorin metodat e vecanta dhe të përgjithshme statistikore• Të jenë në gjendje të bëjnë organizimin dhe të ndjekin fazat e hulumtimit statistikor.• T'i përpunojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara nga puna hulumtuese.

	<ul style="list-style-type: none"> •Të aftësohen në përdorimin e programeve të ndryshme statistikore të cilat cdo ditë e më shumë po e lehtësojnë punën shkencore hulumtuese. 		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Me perfundimin e kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> • Të bëjnë zgjedhjen e problemit për hulumtin • Mbledhjen e shënimeve statistikore (burimore) • T'i grupojnë shënimet statistikore, përpunojnë dhe t'i komentojnë ato • Ti krahasojnë në mënyrë statistikore shënimet mes dukurive të njëjta apo të ndryshme • Të llogarisin dallimet përmes testeve për sinjifikancën (LSD) • Të llogaritnin ANOVA, T-testi dhe F-testi. • Të aftësohen për të punuar mini projekte nga Biostatistika 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	3	3	9
Totali			142
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata ne PP, diskutime, ushtrime laboratorike,		

	pune ne terren, prezentime te studenteve, pune ne grupe
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> •Vijushmeria e rregullt dhe vlersimi i punës praktike 30% •Miniprojektet 20% •Vlerësimi përfundimtar 50% •Vleresimet intermediere
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Gerry P.and Michael J.:Experimental Design and Data Analysis for Biologists •Bekteshi K.:Statistika elementare,2005.Prishtinë. •Elbasani,B.:Biostatistika, 2005,Tiranë •Mynyr Koni.:Biostatistika,2008,Tirane •Hilmi Troni.:Statistika,Prishtine •Paul Maiste.:Probality and statistics for Bioinformatics and Genetics,The Hopkins University,2006 •Hadzhivukoviç,S.:Statisticki metodi,1990,Novi Sad.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> •Cobanovic K.:Primeri za vezbanje iz statistike,1980.Novi Sad. •Cobanovic K.:Primeri za vezbanje iz statistike,1990.Novi Sad

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata qe do te zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Ecuria nga Statistika në Biostatistikë
<i>Java e dytë:</i>	Metodat e biostatistikës
<i>Java e tretë:</i>	Organizimi dhe fazat e hulumtimit statistikor
<i>Java e katërt:</i>	Tabelat statistikore
<i>Java e pestë:</i>	Paraqitjet grafike
<i>Java e gjashtë:</i>	Analiza e shënimeve biostatistikore
<i>Java e shtatë:</i>	LLogaritja parametrave biostatistikor
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi i parë intermedier
<i>Java e nëntë:</i>	Matësit e prirjes qëndrore
<i>Java e dhjetë:</i>	Testimi i hipotezave
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	ANOVA
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	LSD testi dhe t-testi i serive statistikore

<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Regresioni dhe korelacioni
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Prezentimi i punimeve seminarike biostatistikore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë intermedier

Syllabusi për pjesën praktike:

Java	Aktiviteti
<i>Java e parë:</i>	Njohuritë elementare matematikore
<i>Java e dytë:</i>	Probabiliteti
<i>Java e tretë:</i>	Kombinatorika
<i>Java e katërt:</i>	Formimi i klasave dhe i frekuencave distributive
<i>Java e pestë:</i>	Llogaritja parametrave statistikor të shënimit e pagrupuara
<i>Java e gjashtë:</i>	Llogaritja parametrave statistikor të shënimit e grupuara
<i>Java e shtatë:</i>	Hi-katrori
<i>Java e tetë:</i>	Largimi i standardizuar ose vlera e z- së
<i>Java e nëntë:</i>	ANOVA
<i>Java e dhjetë:</i>	ANOVA- vazhdim
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Testi "t" i studentit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Regresioni linear
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Korrelacioni sipas Pearsonit
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Korrelacioni sipas Spirmenit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kontrollim i punimeve biostatistikore

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Vijim i rregullt në ligjerata dhe në ushtrime, hyrja me kohë në sallën e mesimit, mosperdorimi i telefonave dhe respekti i ndersjellte.</i>

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë		
Titulli i lëndës:	Bioteste dhe hematologji		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass. Shemsedin Sadiku		
Detajet kontaktuese:	shemsedin.sadiku@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Lëmia Bioteste dhe hematologji studion rolin e gjakut dhe organeve hematopoetike në trupin e njeriut. Përmes këtyre njohurive sqarohet roli i komponentave të gjakut, funksioni i tyre, detektimi i tyre përmes biotesteve në gjendje të shëndoshë dhe tek sëmundjet.		
Qëllimet e lëndës:			
	<ul style="list-style-type: none"> -Njohja e gjakut, organeve hematopoetike dhe roli i tyre në homeostazën e trupi të njeriut -Rëndësia e njohjes të ndryshimeve të parametrave hematologjik -Zhvillimi i njohurive praktike përmes biotesteve 		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	<ul style="list-style-type: none"> -Njohja e koncepteve bazike në hematologji -Përvetësimi i patobiologjisë të çrregullimeve në hematologji -Aftësia për ti interpretuar testet diagnostike në praktikën klinike në hematologji 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata			
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:			
	-Përdorimi i ligjeratave përmes sllajdeve -Mësimi interaktiv me studentët -Diskutimi përmes pyetjeve analitike -Prezentimi me seminare Mjetet: Librat referentë, punimet shkencore, projektori, modelet anatomike, tabela		
Metodat e vlerësimit:			
	Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes analizës të angazhimit gjatë tërë semestrit/vitit akademik. Dy teste do të vlerësojnë njohuritë nga lëmia, ndërsa aktiviteti në vlerësimin përfundimtar do të përfshihet edhe aktiviteti në ligjerata dhe ushtrime. Sistemi i vlerësimit: 1. Testet 70% 2. Seminarat dhe angazhimi në ligjerata 20% 3. Angazhimi në ushtrime 5% 4. Vijueshmëria 5%		
Literatura			
Literatura bazë:	<i>Medical Physiology.</i> Walter F. Boron, Emile L. Boulpaep <i>Harrisons Principles of Internal Medicine.</i> JL Jameson, A Fauci, D Kasper, S Hauser, D Longo, J Loscalzo		
Literatura shtesë:	Punimet shkencore në revistat ndërkombëtare nga lëmia e hematologjisë.		

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Anatomia dhe fiziologjia e palcës kockore, qelizat burimore kontrolli i hematopoezës
<i>Java e dytë:</i>	Eritropoeza

Java e tretë:	Leukopoeza
Java e katërt:	Anemia, eritrocitoza
Java e pestë:	Metabolizmi i hekurit
Java e gjashtë:	Anemia megalobastike
Java e shtatë:	Çrregullimet e hemoglobinës
Java e tetë:	Çrregullimet jomalinje të qelizave të bardha të gjakut
Java e nëntë:	Leukemia akute, sindromat mielodisplastike
Java e dhjetë:	Leukemia kronike mijeloide, çrregullimet mijeloproliferative
Java e njëmbëdhjetë:	Çrregullimet limfoproliferative, mijeloma multiple
Java e dymbëdhjetë:	Hemostaza, çrregullimet e gjakderdhjes, çrregullimet trombotike
Java e trembëdhjetë:	Farmakologjia e hemostazës
Java e katërmëdhjetë:	Roli i biotesteve në hematologji
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> -Përcjellja e rregullt e ligjeratave dhe ushtrimeve -Angazhimi aktiv në ligjerata dhe ushtrime -Përgaditja e seminareve dhe detyrave tjera -Pjesëmarrja në testim -Respektimi i rregullave të mirësjelljes (qetësia, ruajtja e pajisjeve, kthimi i pajisjeve, largimi nga salla me leje) -Ndalohet praktika e plagjiaturës

Format programi mësimor i lëndës

Të dhënat bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti i Biologjisë
Titulli i lëndës:	Botanikë
Niveli:	Bachelor Biologji molekulare
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (viti i parë)
Numri i orëve për javë:	2+2+1
Vlera e kredive – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	/
Mësimdhënësi:	Prof.dr. Fadil Millaku
Detajet kontaktuese:	fadil.millaku@uni-pr.edu / +377 44 394 000
Përshkrimi i lëndës:	
	<p>Kursi i lëndës Botanikë përfshinë pjesë nga anatomia, morfologjia dhe sistematika e bimëve. Anatomia e bimëve përfshinë citologjinë, histologjinë dhe ndërtimin anatomik të organeve bimore. Morfologjia përfshinë ndërtimin morfologjik të organeve vegetative dhe reproduktive.</p> <p>Pjesa e sistematikës së bimëve përfshinë përshkrimin botanik dhe klasifikimin e grupeve bimore duke filluar nga Bimëve te ulëta (Talophyta) duke vazhduar me Myshqet (Bryophyta), Këputjet (Equisetophyta), Fieroret (Pteridophyta) dhe bimët me farë (Spermatophyta): Farëzhveshura (Gymnospermae) dhe Farëveshurat (Angiospermae). Farëveshurat përfshinë: bimët Dikotile (Dicotiledoneae) dhe Monokotile (Monocotiledoneae).</p>
Qëllimet e lëndës	<p>Objektivat e kursit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i njohurive adekuate për konceptet bazë të botanikës, rendësin e bimëve për jetën në tokë, botën shtazore dhe njerëzimin në përgjithësi. 2. Zhvillimi i aftësive për të njohur dhe kuptuar bazat e botanikës duke filluar nga qeliza deri të klasifikimi i grupeve bimore dhe llojeve bimore me rëndësi shkencore dhe ekonomike. 3. Zhvillimi i aftësive për zbatimin praktik dhe teorik të njohurive të fituara për botën bimore.
Rezultatet e të mësuarit:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studentet do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përshkruajnë dhe të njohin anën anatomiko-morfologjike të bimëve 2. Kuptojnë ndërtimin e qelizës dhe organeleve qelizore 3. Kuptojnë ndërtimin e indeve dhe organeve vegetative

	<ol style="list-style-type: none"> 4. Kuptojnë morfologjinë e organeve vegetative si dhe metamorfozat 5. Kuptojnë morfologjinë dhe rëndësinë e organeve riprodiktive (lules, lulesave, frutave, farës). 6. Mësojnë bazat e taksonomisë së bimëve si dhe grupet e rëndësishme taksonomike të bimëve si: Bimët e ulëta (algat, kërpudhat dhe likenet), Myshqet (Bryophyta), Fiernat (Pteridophyta), Farëzhveshurat (Pynophyta) dhe bimët Farëveshura (Angjiospermae). 7. Dallojnë bimët Dikotile (Magnoliophyta) dhe Monokotile (Liliopsida). 8. Njohin speciet bimore të rëndësishme në aspektin evolutiv, ekonomik dhe mjekësor. 9. Bëjnë prerje të organeve vegetative dhe riprodiktive të bimëve dhe ato t'i analizojnë përmes mikroskopit. 10. Determinojnë grupet bimore dhe speciet e caktuara. 11. Marrin, herbarizojnë apo mbledhin pjesë nga bimët dhe ato t'i përdorin. 12. Orientohen në natyrë me qellim të gjetjes së llojeve bimore të caktuara. 13. Përdorin literaturë adekuate për determinimin e bimëve 14. Përmes çelësit për determinim të përcaktojnë speciet e caktuara. 15. Të kyçën në rrjetën botërore të informatave lidhur me botën bimore. 16. Shfrytëzojnë biblioteka, internet dhe burime tjera për mësim të vetëdrejtuar. 17. Punojnë në mënyrë efektive në grupe ose të pavarur në orët praktike në laborator ose jashtë tij në natyrë.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të mësuarit)			
Aktiviteti	Orët	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime laboratorike	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin	1	6	6
Ushtrime terreni	5	3	15
Prezantime, Seminare	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	6	6
Koha individuale e shpenzuar duke mësuar (në bibliotekë/shtëpi)	2	15	30

Përgatitja përfundimtare për provim	3	10	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, test përfundimtar)	2	2	4
Projekte, prezantime, etj.	2	2	4
Gjithsej	22	76	159

<p>Metodat e mësimdhënies</p>	<p><i>Qasja bazohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Mësimdhënësi shpjegon objektivat e mësimdhënies përmes leksioneve,</i> 2. <i>Nëpërmjet tabelës vizuale dhe mjeteve të tjera paraqiten konceptet dhe teoritë kryesore</i> 3. <i>Do të përdoret mësimi ndërveprues i kombinuar</i> 4. <i>Përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura do të nxirren përfundime të përbashkëta.</i> <p><i>b). Aktivitetet në grup</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Punëtori, diskutime në grup, prezantime në grup</i> <p><i>c). Aktivitete tjera</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Hulumtim i pavarur nga studentët</i> 2. <i>Prezantimi i rezultateve</i> 3. <i>Seminare</i> <p><i>d). Mjetet e punës:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Tekste, artikuj, herbar, tabela, projektor, fletë pune, materiale të përgatitura nga mësuesi etj.</i>
<p>Metodat e vlerësimit</p>	<p><i>Vlerësimi i studentëve do të bazohet në disa kritere bazë. Studentët do të kenë dy teste me shkrim gjatë ligjëratave dhe një test përfundimtar (provim). Vlerësimi dhe notimi do të bëhet duke marrë parasysh suksesin e treguar në teste dhe provimin përfundimtar dhe angazhimin total.</i></p> <p><i>Çdo student ka për obligim të përgatisë një punim seminarik i cili është pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të kësaj lënde. Tema e seminarit duhet të përcaktohet në bashkëpunim me mësuesin në përputhje me planin lëndor të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Notimi do të ndërtohet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:</i></p> <p><i>Testi i parë: 25%</i></p> <p><i>Testi i dytë: 25%</i></p> <p><i>Detyrat e shtëpisë ose angazhime të tjera 15%</i></p> <p><i>Pjesëmarrja e rregullt 5%</i></p> <p><i>Provimi final 30%</i></p> <p><i>gjithsej 100%</i></p>

Literatura	
Literatura bazë:	Millaku, F. (2021): Botanikë e përgjithshme, ligjërata të përgatitura për student Millaku, F. (2015): Praktikum i botanikës së përgjithshme, UHZ, Pejë Toni Nikolic (2013): Sistematska botanika, Alfa, Zagreb. 1 izdanja
Literatura shtesë:	Rexhepi, F. Botanika I dhe II, Prishtinë, (2001) Wilhem, N.: Allgemine Botanik, 11. Aufl. Thieme, Shtuttgart, (2001) Judd, Campbell, Kellog, Stevans, Donoghue (2002): Plant systematics a Phylogenetic aproach. second edition
Dizajnimi i planit studiuës:	
Javë	Ligjëratat që do të mbahen
Java e parë:	Prezantimi i studentëve, prezantimi i profesorit, prezantimi i kurrikulës, njoftim lidhur me vlerësimin dhe notimin. Objekt i prezantimit Botanika e përgjithshme, emërtimi, përmbajtja, ndarja dhe zhvillimi historik.
Java e dytë:	Biologjia qelizore (ndërtimi dhe funksioni i organeleve qelizore)
Java e tretë:	Ndarja qelizore (mitoza dhe mëzoja)
Java e katërt:	Muri (pareti) qelizor, produktet e metabolizmit sekondar në qelizë
Java e pestë:	Indet bimore (histologjia)
Java e gjashtë:	Morfologjia e organeve bimore
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë
Java e tetë:	Riprodhimi i bimëve/ Lulja, simetria, diagrami i lules, lulesat
Java e nëntë:	Fruti dhe fara
Java e dhjetë:	Bazat e taksonomisë së bimëve, Klasifikimi dhe karakteristikat e Kriptogameve (Cryptogamae)
Java e njëmbëdhjetë:	Karakteristikat e bimëve me farë Phanerogamae/Spermatophytes, Klasifikimi dhe karakteristikat e Farëzhveshurat (Gymnospermae)
Java e dymbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë
Java e trembëdhjetë:	Bimët dikotile (Dicotyledoneae)/ Hamamelididae, Coryophyllidae
Java e katërbëdhjetë:	Dillenidae, Rosidae dhe Asteridae
Java e pesëmbëdhjetë:	Bimët Monokotile (Liliatae), karakteristikat morfologjike dhe klasifikimi i tyre.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët me synimin për të arritur sukses të lartë në studime duhet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ndjekin rregullisht ligjëratat, ushtrimet dhe punën në terren. 2. Të marrin pjesë aktive në leksione përmes pyetjeve, debateve dhe formave të tjera të aktiviteteve ndërvepruese. 3. Në marrëveshje me mësuesin të punohet një punim seminari (detyrë shtëpie) prej 7-10 faqesh

4. Të marrin pjesë në vlerësimet e ndërmjetme dhe përfundimtar

5. Gjatë periudhës së leksioneve, ushtrimeve, testeve dhe provim janë të detyruar t'i nënshtrohen Kodit të Sjelljes (heshtje në orar të punës, hyrje në sallë në kohë, lirim i sallës me pëlqimin e mësimitdhënësit etj.).

Syllabus lënde

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN
Titulli i lëndës:	Ekologji
Niveli:	Bachelor / Biologji molekulare
Statusi lëndës:	Z - Zgjedhore
Viti i studimeve:	VI
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	FSHMN - Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Fadil Millaku
Detajet kontaktuese:	+383(0)44 394 000 fadil.millaku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Ky kurs mbulon ekologjinë e bimëve dhe kafshëve në nivel të popullatës, komunitetit dhe të ekosistemit. Fokusi kryesor i këtij kursi është ndërveprimet e organizmave me njëri-tjetrin dhe me mjedisin e tyre abiotik në veçanti ndërveprimet midis organizmave të gjallë në tipe të ndryshme të habitateve dhe ndikimi i klimës (reshjeve) dhe faktorëve tjerë abiotik në organizimin e popullatës dhe individëve në kuadër të popullatës. Në ekologji pothuajse gjithçka varet nga gjëra që janë të ndërlidhura me njëra tjetrën, d.m.th., prania ose mungesa e organizmave të tjerë etj. Kjo e bën shumë të vështirë marrjen në konsideratë të fakteve të veçanta ndaras, dhe përmbajtja e këtij kursi do të fokusohet në të kuptuarit e ndërlidhjeve mes koncepteve dhe fakteve të ndryshme. Megjithatë lënda e Ekologjisë fokusohet në ekologjinë bazike dhe të përgjithshme, do të shqyrtohen marrëdhëniet ndërmjet shkencës së ekologjisë së përgjithshme dhe problemeve aktuale mjedisore duke i ndërlidhur edhe me ndryshimet klimatike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi i ofruar, ndër të tjera do ju mundësojë studentëve që:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Njohin faktet bazë të ekologjisë në nivel të popullatës, komunitetit dhe ekosistemit.2. Të jenë në gjendje të flasin dhe të shkruajnë qartë dhe saktë për konceptet kryesore Ekologjike.3. Të njohin ndërlidhjet midis koncepteve kryesore të ekologjisë.4. Të kuptojnë se si provat empirike (d.m.th., të dhënat) mbështesin ose hedhin poshtë konceptet

	<p>kryesore.</p> <p>5. Të jenë në gjendje të përpilojnë një studim ekologjik i cili adreson pyetjet profesionale, të kryejnë studime duke përdorur pajisjet e duhura dhe të interpretojnë (dhe prezantojnë) rezultatet e studimeve para të tjerëve.</p> <p>6. Janë në gjendje të analizojnë se si konceptet bazike ekologjike të mësuara lidhen me problemet aktuale mjedisore.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <p>1. Kuptojnë dhe aplikojnë metoda shkencore duke përfshirë metodat në terren dhe ato laboratorike (vëzhgimi, marrja e mostrave, regjistrimi i të dhënave, analiza e të dhënave dhe raportimi i të dhënave).</p> <p>2. Të njohin dhe demonstrojnë principet dhe konceptet bazike të ekologjisë, duke përfshirë strukturën dhe funksionin e ekosistemeve, dinamikën e popullsisë, rrjedhën e energjisë nëpër ekosisteme dhe ciklet biogjeokimike.</p> <p>3. Kuptojnë ndërlidhjen e të gjithë faktorëve që ndikojnë në pasurinë dhe shumëllojshmërinë e specieve brenda një komuniteti ose ekosistemi dhe të kenë aftësi për të përshkruar llojet e ndryshme të ndërveprimeve ndërmjet anëtarëve të një komuniteti.</p> <p>4. Nëpërmjet eksperimenteve dhe raporteve laboratorike, studentët do të demonstrojnë kompetencë në përdorimin e teknologjive dhe teknikave përkatëse për mbledhjen dhe analizën e të dhënave.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsejtë
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	2
Punë praktike	1	1/8	8
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/7	7
Ushtrime në terren	2	1/14	28
Kollokfiume, seminare	2	1/2	4
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1/3	6

Projektet, prezantimet, etj.			
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Punë praktike, Ligjërata, Diskutime (Bashkëbisedim), Seminare (Detyra) 		
Metodat e vlerësimit:	<p style="text-align: center;">Vlerësimi në praktikë dhe në teori</p> <p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësimi i parë deri 30 %</p> <p>Vlerësimi i dytë deri 30 %</p> <p>Vijimi dhe detyrat deri 10 %</p> <p>Provimi final deri 30 %</p> <p>Totali 100 %</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjërata të përgatitura nga mësimdhënësi • Molles, M. C., & Laursen, A. (2020): Ecology: Concepts and Applications. McGraw-Hill Ryerson. 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Peja, N. (2005): Ekologjia. SHBLU - Tiranë. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në kurs - Çfarë është Ekologjia (një përmbledhje)
<i>Java e dytë:</i>	Jeta në tokë dhe në ujë - Gjenetika e populacioneve dhe përzgjedhja natyrore
<i>Java e tretë:</i>	Marrëdhëniet me energjinë dhe lëndët ushqyese. Marrëdhëniet shoqërore të organizmave.
<i>Java e katërt:</i>	Shpërndarja, preferencat ekologjike dhe abundanca e populacioneve
<i>Java e pestë:</i>	Rritja e popullsisë. Abundanca dhe shumëllojshmëria e taksoneve jetësore.
<i>Java e gjashtë:</i>	Ndërveprimet e specieve dhe struktura e komuniteteve. Konkurrenca.
<i>Java e shtatë:</i>	Prodhimi primar dhe rrjedha e energjisë Vlerësimi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Popullatat e bimëve dhe kafshëve - çfarë është një individ?
<i>Java e nëntë:</i>	Vazhdimësia dhe Stabiliteti.
<i>Java e dhjetë:</i>	Klasifikimi i ekosistemeve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ekologjia e konservimit. Shembujt, trendët dhe përvoja.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Sukcesioni, dëmtuesit dhe barojat e këqija.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Ekosfera.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Biodiversiteti, rëndësia dhe konceptet.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Ngrohja globale Vlerësimi i dytë
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimet që do të zhvillohen
<i>Java e parë:</i>	Përshkrimi i popullatës nga vërtetimi
<i>Java e dytë:</i>	Përlllogaritja e madhësisë së popullatës (shembuj bimët)
<i>Java e tretë:</i>	Përlllogaritja e madhësisë së popullatës (shembuj kafshët)
<i>Java e katërt:</i>	Llogaritja e rritjes së popullsisë
<i>Java e pestë:</i>	Nishat ekologjike të bimëve në një mjedis të trazuar
<i>Java e gjashtë:</i>	Vlerësimi i biodiversitetit të komunitetit pyjor (me vizitë në natyrë)
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi i biodiversitetit të komunitetit pyjor (analizë vetanake në laborator)
<i>Java e tetë:</i>	Matja e abundancës së llojeve bimë
<i>Java e nëntë:</i>	Matja e abundancës së llojeve shtazore
<i>Java e dhjetë:</i>	Diversiteti i bimëve dhe i kafshëve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Mbledhja dhe trajtimi i të dhënave
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Tregues ekologjik
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Tregues ekologjik – vazhdim
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Ndikimi i bimësisë aliene në habitatet natyrore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantim projekti nga studentët

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet të jenë të rregullt në mësim, aktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, të përgatiten, të jenë në gjendje të marrin te dhëna nga interneti, të bëjnë pyetje gjatë seancave mësimore. Duhet të mbajnë disiplinë, t'i shkyçin telefonat celular, të vijnë me kohë në ligjërata dhe në ushtrime dhe në çfarëdo forme të mos e pengojnë mbarëvajtjen e mësimit.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Endokrinologji e Njeriut
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Merita Emini-Sadiku
Detajet kontaktuese:	merita_endo@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	
	Endokrinologjia e Njeriut është disiplinë mjekësore e cila mirret me studimin e funksionit të gjëndrave të cilat prodhojnë substancat të quajtura hormone. Sistemi endokrin është një prej sistemeve kryesore i cili shërben për mirëmbajtjen e homeostazës të njeriut. Produktet e këtij sistemi, hormonet, ndikojnë në të gjitha qelizat e njeriut, rrjedhimisht edhe në fiziologjinë e trupit të njeriut.
Qëllimet e lëndës:	<p>-Lënda e Endokrinologjisë të Njeriut ka për qëllim që studentëve të ju sigurojë njohuri të mjaftueshme mbi funksionimin e organizmit të njeriut</p> <p>-Studentët do të mësojnë mbi funksionim e zemrës, sistemin e frymëmarrjes, sekrecionit të hormoneve, si dhe shumë procese të tjera fiziologjike</p> <p>-Njohja e funksionimit të secilit organ dhe roli i saj në procesin e mbajtjes së "balancit dinamik" është bazë për të kuptuar funksionimin normal të organizmit si dhe mundësitë e gjendjeve patologjike</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>-Njohja e koncepteve bazë të funksionit të sistemit endokrin</p> <p>-Fitimi i njohurive të mjaftueshme mbi mënyrën e integritit të gjëndrave endokrine</p> <p>-Njohja e efektit të hormoneve në nivelet subqelizore dhe molekulare</p> <p>-Kuptimi i funksionimit të gjëndrave endokrine nga</p>

modelet në praktikë			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata			
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësime dhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>-Përdorimi i ligjeratave përmes sllajdeve -Mësimi interaktiv me studentët -Diskutimi përmes pyetjeve analitike -Prezentimi me seminare</p> <p>Mjetet: Librat referentë, punimet shkencore, projektori, modelet anatomike, tabela</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes analizës të angazhimit gjatë tërë semestrit/vitit akademik. Dy teste do të vlerësojnë njohuritë nga lëmia, ndërsa aktiviteti në vlerësimin përfundimtar do të përfshihet edhe aktiviteti në ligjerata dhe ushtrime.</p> <p>Sistemi i vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Testet 70% 2. Seminarat dhe angazhimi në ligjerata 20% 3. Angazhimi në ushtrime 5% 4. Vijueshmëria 5% 		
Literatura			
Literatura bazë:	Fiziologjia e Njeriut nga Artan Shkoza.		

	<i>Medical Physiology.</i> Walter Boron, Emile L Boulpaep. <i>Harrisons Principles of Internal Medicine.</i> JL Jameson, A Fauci, D Kasper, S Hauser, D Longo, J Loscalzo
Literatura shtesë:	Punimet shkencore në revistat ndërkombëtare nga lëmia e endokrinologjisë.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Endokrinologji, klasat e hormoneve, mekanizmat e feedbackut, receptorët
<i>Java e dytë:</i>	Hormonet steroide
<i>Java e tretë:</i>	Hipotalamusi dhe lobi i përparmë i hipofizës
<i>Java e katërt:</i>	Hipotalamusi dhe lobi i pasmëil hipofizës
<i>Java e pestë:</i>	Gjendra tiroide
<i>Java e gjashtë:</i>	Hormonet e traktit tretës
<i>Java e shtatë:</i>	Pankreasi endokrin
<i>Java e tetë:</i>	Palca e gjëndrës mbiveshkore
<i>Java e nëntë:</i>	Gjendra mbiveshkore
<i>Java e dhjetë:</i>	Hormonet e veshkëve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Hormonet e zemrës dhe enëve të gjakut
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Hormonet e traktit respirator
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Androgjenet
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Estrogjenet dhe endokrinologjia e shtatzanisë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> -Përcjellja e rregullt e ligjeratave dhe ushtrimeve -Angazhimi aktiv në ligjerata dhe ushtrime -Përgaditja e seminareve dhe detyrave tjera -Pjesëmarrja në testim -Respektimi i rregullave të mirësjelljes (qetësia, ruajtja e pajisjeve, kthimi i pajisjeve, largimi nga salla me leje) -Ndalohet praktika e plagjiaturës

Evucioni biologjik

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN -Departamenti i biologjisë
Titulli i lëndës:	Evucioni biologjik
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III, semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2+0+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Kasum Letaj
Detajet kontaktuese:	E-mail: kasum.letaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Në këtë lëndë përshkruhen: teoritë, argumentet, faktorët e evucionit biologjik, speciacioni dhe formimi i njësive të larta taksonomike (makroevucioni). Po ashtu do të përshkruhen: rrugët e evucionit, evucioni në nivel molekular si dhe origjina biologjike dhe evucioni i njeriut.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi lëndës është që studentët gjatë ligjëratave do të njohin: teorinë, argumentet, faktorët dhe rrugët e evucionit, si dhe procesin e speciacionit dhe formimit të njësive të larta taksonomike. Po ashtu, studentët do njihen me ndryshimet elementare të organizmave në kushte të tanishme nën ndikimin e një varg kushtesh të mjedisit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë teorinë e krijimit historik të evucionit të qenieve të gjalla. • Shpjegojnë ndryshueshmërinë e qenieve të gjalla si rezultat i marrëdhënieve në mes të individëve të popullatave të njëjtë lloj. • Analizojnë faktorët që kanë sjelli deri te evucioni biologjik dhe krijimi i llojeve të reja. • Ndërtojnë koncepte për evucionin biologjik. • Vlerësojnë rolin e ndryshimit të faktorëve gjenetikë në paraqitjen e llojeve të reja.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)	

Aktiviteti	Orë	ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	-	-	-
Punë praktike	-	-	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	8/semestër	-	8
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare	2	15	30
Detyra të shtëpisë	6/semestër	-	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	6/semestër	-	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4/semestër	-	4
Projektet,prezantimet ,etj	6/semestër	-	6
Totali			150 orë
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, diskutime, punë në grupe dhe seminare.		
Metodat e vlerësimit:			
	Vlerësimi përfundimtar paraqet shumën: Vlerësimi të parë intermedier;25% Vlerësimi të dytë intermedier:25% Vijimit të rregullt dhe angazhimit në diskutime dhe seminare 20% Provimit final me test ose me gojë: 30% Totali: 100 %		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Zyri Bajrami, <i>Mynyr Koni: Teoria e evolucionit</i> . Tiranë 2000		
Literatura shtesë:	1. Mark Ridley: <i>Evolution</i> , thirr edition, 2004, Blackwell Publishing. 2. Roger Lewin and Robert A. Foley: <i>Principles of Human Evolution</i> , second edition, 2004, Blackwell Publishing.		

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje ne evolucionin biologjik
Java e dytë:	Teoria e Darvinit mbi evolucionin. Teoria sintetike e evolucionit
Java e tretë:	Argumentet e evolucionit
Java e katërt:	Teoria e biogjenezës
Java e pestë:	<i>Variabiliteti</i> si faktor i evolucionit
Java e gjashtë:	<i>Seleksionimi</i> si faktor i evolucionit
Java e shtatë:	<i>Izolimi</i> si faktor i evolucionit
	Vlerësimi i parë intermrdier
Java e tetë:	Drifti gjenetik si faktor i evolucionit
Java e nëntë:	Organizmat dhe mjedisi jetësor
Java e dhjetë:	Procesi i evolucionit; Speciacioni
Java e njëmbëdhjetë:	Formimi i njësive të larta taksonomike (makroevolucioni)
	Vlerësimi i dytë intermrdier
Java e dymbëdhjetë:	Rrugët e evolucionit
Java e trembëdhjetë:	Evolucioni në nivel molekular
Java e katërbëdhjetë:	Origjina biologjike dhe evolucioni i njeriut
Java e pesëmbëdhjetë:	Biodiverziteti i njeriut të sotëm

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, dhe se punë seminarike. Mbjajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimi etj..

Në mënyrë që ti nënshtrohet vlerësimit të parë dhe të dytë studenti është i obliguar që ti ndjek së paku 70% të ligjeratave.

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Biologjisë, Programi: Biologji Molekulare
Titulli i lëndës:	Fizika
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i parë, Semestri i dytë
Numri i orëve në javë:	2 orë ligjërata dhe 2 orë ushtrime
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	////////////////////
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Sefer Avdiaj
Detajet kontaktuese:	sefer.avdiaji@uni-pr.edu Koha e konsultimeve: ////////////////////// Projektet dorëzohen në fund të semestrit
Përshkrimi i lëndës	
	Ky është një kurs bazë një-semestral i fizikës për studentët e biologjisë. Ky kurs paraqet përdorimin e metodave fizike në studimin e sistemeve biologjike, si dhe trajtimin dhe shpjegimin e problemeve aktuale biologjike. Metodrat dhe teknikat fizike përdoren për të studiuar fenomenet që ndodhin në organizmat e gjallë në të gjitha nivelet e organizimit të tyre. Ushtrimet laboratorike janë të detyrueshme.
Qëllimet e lëndës:	-Të kuptoj se një numër i vogël i parimeve themelore të fizikës. -Të fitoj shkathtësi për modelimin e proceseve komplekse që ndodhin në biologjinë moderne duke zbatuar parimet themelore të fizikës. -Zhvilloj shkathësitë e punës laboratorike, të komunikimit dhe punës në grup
Rezultatet e pritura të nxënies:	- din konceptet themelore dhe ligjet e fizikës - zbaton konceptet fizikës në situata reale. - praktikoj zbatimin e arsytimit kuantitativ dhe procedurave matematikore për një situatë të caktuar që të parashikoj rezultatin e saj - hulumtoj eksperimentalisht fenomene të caktuara fizike. - krahasoj dhe të nxjerrë konkluzione rreth fenomeneve të ndryshme në fizikë për situata reale

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënëit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	10		10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj	10		10
Totali			125 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, punë laboratorike, projekte, diskutim, punë në grupe.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 20% Vlerësimi i dytë 20% Projekti dhe detyrat 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 45% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Dr. Qerim Kamberi, Fizika e përgjithshme, , Prishtinë, 1998		
Literatura shtesë:	Dr. S. Skenderi, Dr. R. Maliqi, Fizika për studentët e fakulteteve teknike, Prishtinë. D. Halliday, R. Resnik, J. Walker, Fundamental of Physics- Sixth Edition, John Willey & Sons Inc, 2003 Robert Splinter (ed), Handbook of physics in medicine and biology. CRC Press 2010 Paul Davidovits Physics in Biology and Medicine		

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Kinematika në një dimension
<i>Java e dytë:</i>	Forca dhe ligjet e Njutonit.
<i>Java e tretë:</i>	Puna, energjia dhe fuqia.
<i>Java e katërt:</i>	Lëkundjet dhe elasticiteti
<i>Java e pestë:</i>	Hidrostatika dhe hidrodinamika.
<i>Java e gjashtë:</i>	Nxehtësia dhe termodinamika.
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Valët dhe zëri.
<i>Java e nëntë:</i>	Forcat elektrike dhe fushat elektrike,
<i>Java e dhjetë:</i>	Forcat magnetike dhe fushat magnetike.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Drita dhe optika.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Natyra duale e materies dhe rrezatimit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Fizika atomike
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Fizika bërthamore.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dyte.

Plani i detajuar i ushtrimeve eksperimentale

Nr	Ushtrimi eksperimental
1	Matja e gjatësisë me nonius dhe vidë mikrometrike
2	Përcaktimi i nxehtësisë së avullimit të ujit me kalorimetër
3	Përcaktimi i peshës specifike të lëngjeve me hidrometër
4	Përcaktimi i nxehtësisë specifike të trupave të ngurtë me kalorimetër
5	Përcaktimi i indeksit të thyerjes me mikroskop optik
6	Përcaktimi i koeficientit të viskozitetit të lëngjeve me metodën e Stoksit
7	Përcaktimi i raportit C_p/C_v të nxehtësisë specifike të ajrit
8	Vërtetimi i ligjit të Boyle-Mariott-it
9	Vërtetimi i ligjit të Ohm-it
10	Përcaktimi i rezistencës së panjohur me urën e Wheatstone-it
11	Përcaktimi i largësisë fokale të thjerrëzës me metodën direkte dhe të Besselit
12	Përcaktimi i fuqisë së nxemësit elektrik
13	Përcaktimi i nxitimit të rëndimit tokësor me lavjerrës matematik

14	Përcaktimi i modulit të elasticitetit me metodën e Young-ut
15	Përcaktimi i peshës specifike të trupave të ngurtë me peshojë hidrostatike
16	Matja e shpejtësisë së zërit me gypin e rezonancës
17	Përcaktimi i tensionit sipërfaqësor me metodën e gypit kapilar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Pritet që studenti të përçjell me rregull ligjëratat dhe ushtrimet</i> - <i>Studentët duhet të mbajnë qetsi në sallë dhe të jenë të koncentruar në mësim</i> - <i>Gjatë kohës së ligjëratave të shkyqen telefonat celular</i> 	

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Programi: Biologji molekulare
Titulli i lëndës:	Fiziologjia e bimëve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (i dytë)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E martë dhe mërkure, ora: 10-12, FSHMN
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Bekim Gashi
Detajet kontaktuese:	bekim.gashi@uni-pr.edu; cel: +386 49 600 850
Përshkrimi i lëndës	
	Hyrje në fiziologjinë e bimëve. Qeliza bimore - funksionet e: membranave qelizore, murit qelizor, mikrotrupthave, plastideve, vakuolës dhe citoskeletit. Uji dhe qeliza bimore – mekanizmat e absorbimit, transportit dhe lirit. Ushqimi mineral i bimëve. Fotosinteza, reaksionet fotokimike, transporti i elektroneve, sinteza e ATP. Cikli i Kalvinit. Metabolizmi C3, C4 dhe CAM. Fotofrymëmarrja. Faktorët që ndikojnë në fotosintezë. Procesi i frymëmarrjes te bimët. Rritja dhe zhvillimi i bimëve, rregullatorët e rritjes. Hormonet bimore: auksinet, citokininet, giberelinet, etileni dhe acidi abcisinik. Fotoreceptorët e bimëve, efekti i dritës në rritjen dhe zhvillimin e bimëve. Fiziologjia e rezistencës së bimëve dhe metabolitët sekondar. Lëvizjet e bimëve.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka si qëllim që studentëve t'u ofrojë njohjen e proceseve fiziologjike që kryhen në organizmat bimor dhe njohjen e ligjshmërive fiziko-kimike që mundësojnë kryerjen e proceseve të ndryshme fiziologjike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë se si aplikohen konceptet bazë të Fiziologjisë së bimëve në disiplina të tjera të biologjisë. • Të sqarojnë principet dhe proceset kryesore për funksionet e qelizës bimore dhe gjithë bimës. • Të analizojnë lidhshmërit ndërmjet strukturës dhe funksionit të qelizës në nivele të ndryshme. • Të kuptojnë rëndësinë e procesit të ushqimit

	<p>mineral, transpirimit, fotosintezës dhe të frymëmarrjes te organizmat bimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojnë dhe të shpjegojnë proceset e rritjes dhe zhvillimit të bimëve. • Të përdorin materialin bimor, pajisjet laboratorike dhe metodat e aplikuara në fiziologjinë e bimëve. • Të realizojnë eksperimente laboratorike dhe analizojnë rezultatet e arritura. • Të aplikojnë konceptet bazë të praktikës së fiziologjisë së bimëve në praktikë. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike	5	1 javë	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5 javë	5
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiime,seminare	2	2 javë	4
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15 javë	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2.5	10 javë	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3 javë	6
Projektet,prezentimet ,etj	/	/	/
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, kuize, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
Metodat e vlerësimit:	<p>1. Mundësia e vlerësimit gjatë leksioneve: Vlerësimi i parë (kolokvium, pyetje të mbyllura): 30% Vlerësimi i dytë (kolokvium, pyetje gjysmë të hapura): 30% Vlerësimi përfundimtarë (pyetje të hapura): 30% Seminaret ose angazhime tjera: 10% Total: 100%</p> <p>2. Apo pas përfundimit të leksioneve (në afatet e provimeve): Vlerësimi me test me një rën nga tri format e</p>		

	sipërpërmendura apo provim me gojë.
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lincoln Taiz, Eduardo Zeiger, Ian M. Moller and Angus Murphy: Fiziologjia dhe zhvillimi i bimëve, 6th edition (in Albanian). Oxford University Press, 2014. 2. Bekim Gashi: Praktikum i Fiziologjisë së bimëve (dispensë), 2015.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Vjollca Ibro: Fziologjia e bimëve. Universiteti Bujqësor i Tiranës. • Lincoln Taiz and Eduardo Zeiger: Plant Physiology, 5th edition, Sunderland, USA, 2010. • Fiziologjia e bimëve (dispensë ligjëratash)

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në fiziologjinë e bimëve. Qeliza bimore – funksionet e membranave qelizore, plastideve, mikrotrupthave, vakuolës dhe citoskeletit.
Java e dytë:	Muri qelizor – funksionet dhe biosinteza. Përbërja kimike e protoplazmës.
Java e tretë:	Uji dhe qelizat bimore – absorbimi, transporti dhe lirimi i ujit.
Java e katërt:	Ushqimi mineral i bimëve. Elementet makrometabolike dhe mikrometabolike.
Java e pestë:	Asimilimi i materieve minerale (azoti, sulfuri, fosfori, oksigjeni, kationet). Kolokfiumi I.
Java e gjashtë:	Fotosinteza – organizimi i aparatit fotosintetik, reaksionet fotokimike.
Java e shtatë:	Cikli i Kalvinit dhe rregullimi i tij. Fotofrymëmarrja. Bimët e tipit C3, C4 dhe CAM.
Java e tetë:	Aspektet fiziologjike dhe ekologjike të fotosintezës. Sintezë e amidonit dhe saharozës. Transporti i asimilateve nëpër floemë.
Java e nëntë:	Procesi i frymëmarrjes në bimë. Metabolizmi i sheqernave dhe yndyrnave. Heterotrofia te bimët.
Java e dhjetë:	Rritja, diferencimi dhe zhvillimi i bimëve. Kolokfiumi II.
Java e njëmbëdhjetë:	Hormonet bimore: auksinet dhe giberelinet.

Java e dymbëdhjetë:	Hormonet bimore: citokininet, etilen, acidi abscisik dhe substancat tjera endogjene.
Java e trembëdhjetë:	Ndikimi i faktorëve të jashtëm në rritje dhe zhvillim të bimëve. Efekti i dritës në rritjen dhe zhvillimin e bimëve.
Java e katërbëdhjetë:	Fiziologjia e streseve bimore. Metabolizmi sekondar dhe mekanizmat e mbrotjes së bimëve
Java e pesëmbëdhjetë:	Fiziologjia e lëvizjes së bimëve. Kolokfiumi III.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësime janë po ashtu të obligueshme.

Ushtrimet

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimi që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftim i përgjithshëm me praktikën e Fiziologjisë bimore – sqarimi mbi hartimin e një Raporti laboratorik bashkërisht, Praktikumi dhe Planprogrami.
Java e dytë:	Lëshueshmëria e membranave qelizore bimore nën ndikimin e faktorëve kimik dhe fizik (ndikimi i tretësve organik, i acideve dhe bazave, i joneve dhe i temperaturave të larta).
Java e tretë:	Osmoza – Qelizat Traube dhe të Pfefferit. Plazmoliza e qelizave bimore.
Java e katërt:	Fuqia thithëse e indeve bimore dhe metodat për përcaktimin e saj. Lëshueshmëria për ujë e kërcejve drunor.
Java e pestë:	Regjimi ujqor i bimëve – përcaktimi i sasisë së ujqit të lirë, ujqit higroskopik, ujqit të tërësishëm në bimë dhe sasisë relative të ujqit (RWC).
Java e gjashtë:	Transpirimi – demonstrimi i tij nga faqja dhe kundërfaqja e gjethit. Matja e intensitetit të transpirimit me metodën peshuese dhe me ndihmën e gypit “U”.

Java e shtatë:	Demonstrimi i gutimit në kushte laboratorike. Përcaktimi i sipërfaqes asimiluese (me metodën e konturave të gjetes në letër dhe me metodën e copave rrethore).
Java e tetë:	Analiza kualitativo-kuantitative e pigmenteve të kloroplastit me metodën UV-VIS spektrofotometrike
Java e nëntë:	Ndarja e pigmenteve të kloroplastit me metodën e kromatografisë në letër. Vërtetimi i veçorive të klorofileve (ndikimi i acideve dhe i bazave në klorofil, fluoreshenca e klorofilit).
Java e dhjetë:	Identifikimi i karbohidrateve të krijuara gjatë procesit të fotosintezës (identifikimi i amidonit në gjethe & identifikimi i sheqernave reduktuese).
Java e njëmbëdhjetë:	Fermentimi alkoolik.
Java e dymbëdhjetë:	Matja e aktivitetit të Amilazës.
Java e trembëdhjetë:	Përcaktimi i aktivitetit të Saharazës.
Java e katërbëdhjetë:	Analiza kualitative e hirit (kalciumi, hekuri dhe sulfuri).
Java e pesëmbëdhjetë:	Hulumtimi biokimik i vitalitetit të farave.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN,Departamenti i Biologjisë
Titulli i lëndës:	Fiziologjia e shtazëve
Niveli:	bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III, semestri i pestë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.dr. Kemajl Bislimi
Detajet kontaktuese:	<u>kemajlbislimi@yahoo.com</u> <u>kemajl.bislimi@uni-pr.edu</u> tel. 044-243-470
Përshkrimi i lëndës	Lënda fiziologjia shtazëve në këtë kurs jep informacione lidhur me proceset bazike të fiziologjisë, të tilla si homeostaza dhe mekanizmat tjere rregullues. Poashtu tregon tipet e sistemit të tretjes të grupet e ndryshme të organizmave. Një hapësirë i kushtohet lëngjeve trupore hemolimfa, gjaku, plazma dhe elementet e gjakut si dhe roli i tyre, duke përshkruar format e imunitetit. Gjithashtu trajtohet edhe sistemi i qarkullimit të gjakut dhe procesit të frymëshkëmbimit. Në kapitullin e sistemit nervor ipen informata për rolin si dhe për format tjera të komunikimit sinaptik dhe hormonal. Në kapitujt e fundit spjegohen organet ekskretuese si dhe metabolizmi energjetik duke përfshirë metodat e matjes direkte dhe indirekte.
Qëllimet e lëndës:	Programi mësimor i lëndës Fiziologjia e shtazëve, ka për qëllim që studenti të: <ul style="list-style-type: none"> - zhvilloj aftësi për të njohur dhe kuptuar proceset, funksionet dhe manifestimet fiziologjike dhe interpretuar saktë mekanizmat e homeostazës, - zgjeroj dhe thelloj njohuritë për morfologjinë funksionale të membranës qelizore dhe transportin transmembranor të materieve në të, anatominë fiziologjike të qelizës nervore dhe muskulore, - të njoh terminologjinë fiziologjike , të kuptoj faktet, konceptet ,parimet dhe metodat fiziologjike si dhe relacionin shkak –efekt, - të zhvillojë të menduarit kritik të funksionimit të sistemeve të tretjes, qarkullimit të gjakut, frymëshkëmbimit, nervor, imunitar, ekskretues - fitoj aftësi për mbledhje dhe përpunim të të dhënave relevante shkencore nga fiziologjia prej burimeve të ndryshme dhe shkathtësi,për të zbatuar njohuritë e fituara në praktikë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon faktet, konceptet,parimet dhe metodat

	<p>fiziologjike dhe sjellë shembuj për relacionin shkak – efekt, fidbekun pozitiv dhe negativ dhe përshkruan mekanizmat rregullues të homeostazës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emerton tipet e ndryshme të lëngjeve trupore, përshkruan përbërjen e gjakut dhe rolin fiziologjik të elementeve korpuskulare dhe plazmës së gjakut. - Vlerëson rendesine e sistemit të organeve për qarkullimin e lëngjeve trupore. - Shpjegon bazën qelizore dhe humorale të përgjigjes imunologjike, dallon imunitetin aktiv nga imuniteti pasiv si dhe imunitetin specifik nga imuniteti jo specifik - Shpjegon konceptet e përgjithshme fiziologjike për frymëshkëmbimin, tretjen, ekskretimin, sistemin lokomotor, sistemin rregullues (endokrin dhe nervor) dhe metabolizmin energjetik. - Dallon tipet e organeve të frymëmrrjës, të tretjes dhe organeve ekskretuese të grupet e ndryshme sistematike dhe dhe shpjegon mekanizmin e funksionimit të tyre. - Përshkruan anatominë dhe fiziologjinë (dhe organizimin brendaqelizor) të qelizës nervore dhe muskulore, argumenton bazën jonike të potencialeve bioelektrike - Analizon mekanizmin e përcjelljes së impulsit nga një qelizë në tjetrën-sinapsat - Grumbullon të dhena shkencore relevante nga interneti dhe burime tjera lidhur me temat e zhvilluara.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiime,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	13	13
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
			150

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjerata tradicionale, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutim, debate etj. Puna në grupe do të jetë një prej mënyrave të garimit për të nxënë sa më shumë njohuri dhe për të rritur një konkurrencë pozitive brenda studentëve. Për ilustrim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhë materiale vizuale: si sllajde, figura, skema, videoprojektor, modele etj. Për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive të plota dhe të qëndrueshme, do të përzgjedhen metoda më të përshtatshme të mësimdhënies e mesimnxënies në mënyrë që të nxisin maksimalisht të</p>
-------------------------------------	---

	nxënit aktiv të studentit.
Metodat e vlerësimit:	<p>Do të përdorë mjete dhe teknika të ndryshme për të mbledhur informacione të mjaftueshme për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së studentit</p> <p>Vlerësimi bëhet në pjesën praktike dhe teorike. Pjesa praktike e provimit është eliminuese. Vlerësimi në pjesën teorike të lëndës do të bëhet duke aplikuar variantin e vlerësimit sipas procesit të Bolonjës dhe tradicional (me gojë) me zbatim të tri segmenteve të objektivit (veprimin, kushtin dhe kriterin).</p> <p>Përqindja e pikave në vlerësim</p> <p>Vlerësimi i parë 40 %</p> <p>Vlerësimi i dytë 40 %</p> <p>Angazhime të tjera 15</p> <p>Vijimi i rregullt 5%</p> <p>Total 100%</p> <p>Pikët e fituara do të konvertohen në notë sipas sistemit ECTS.</p>

Literatura	
Literatura bazë dhe e preferuar:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ethem Ruka, Fiziologjia e gjallesave shtazore, Tiranë, 1999 2. Dervish A. Rozhaja, Fiziologjia krahasuese, Prishtinë, 2000 3. Fetah Halili, Fiziologji e përgjithshme, Prishtinë, 1997 4. Tefta Rexha, Biologjia qelizore dhe molekulare, Tiranë, 2002 5. S.C. Rastogi, Essentials of animal physiology, New Age International Ltd., Publishers, 2007 6. Artan Shkoza, Fiziologjia e njeriut, Tiranë, 2009 7. Herve Guenard, Fiziologjia e njeriut, 1996 8. Luljeta Çakërri, Rexhep Bregu, Fiziologjia mjekësore, Tiranë, 1999

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Lënda , metodat dhe detyrat e fiziologjisë
Java e dytë:	Homeostaza
Java e tretë:	Sistemi i tretjes
Java e katërt:	Lëngjet trupore- Gjaku
Java e pestë:	Imuniteti
Java e gjashtë:	Funksionet e sistemit vaskular- qarkullimi i gjakut
Java e shtatë:	Frymëshkëmbimi
Java e tetë:	Disa aspekte ekologjike të frymëshkëmbimit Vlerësimi i parë intermediar
Java e nëntë:	Sistemi nervor qendror
Java e dhjetë:	Sistemi nervor periferik
Java e njëmbëdhjetë:	Receptorët- shqisat
Java e dymbëdhjetë:	Sistemi endokrin
Java e trembëdhjetë:	Ekskrecioni
Java e katërbëdhjetë:	Metabolizmi
Java e pesëmbëdhjetë:	Balanca energjetike e trupit Vlerësimi i dytë intermediar

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimet që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Protokolli eksperimental
<i>Java e dytë:</i>	Narkoza dhe anestezioni te kafshët
<i>Java e tretë:</i>	Hematokriti
<i>Java e katërt:</i>	Grupet e gjakut
<i>Java e pestë:</i>	Koagulimi i gjaku
<i>Java e gjashtë:</i>	Eritrocitet si osmometer
<i>Java e shtatë:</i>	Sjellja e eritrociteve ne tretësira izo, hipo dhe hipertone
<i>Java e tetë:</i>	Testi i dilucionit
<i>Java e nëntë:</i>	Pneumografia dhe frymemarrja
<i>Java e dhjetë:</i>	Tretja te shpendët
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Imobilizimi kirurgjik i kafshëve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Pregaditja e preparatit neuromuskulor
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Analiza e tkurrjes unitare
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sumacioni dhe tetanus i tkurrjes muskulore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Analiza e harkut reflektiv

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësime janë po ashtu të obligueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Fiziologjia e Njeriut
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Driton Vela
Detajet kontaktuese:	driton.vela@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Lënda e fiziologjisë ka për qëllim që studentëve t' u sigurojë njohuri të mjaftueshme mbi funksionimin e normal të organizmit të njeriut. Përmes kësaj lëmie kuptohet funksioni i trupit të njeriut në çdo nivel të organizimit të jetës.
Qëllimet e lëndës:	
	<p>-Lënda e fiziologjisë ka për qëllim që studentëve të ju sigurojë njohuri të mjaftueshme mbi funksionimin e organizmit të njeriut</p> <p>-Studentët do të mësojnë mbi funksionim e zemrës, sistemin e frymëmarrjes, sekrecionit të hormoneve, si dhe shumë procese të tjera fiziologjike</p> <p>-Njohja e funksionimit të secilit organ dhe roli i saj në procesin e mbajtjes së "balancit dinamik" është bazë për të kuptuar funksionimin normal të organizmit si dhe mundësitë e gjendjeve patologjike</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	<p>-Njohja e koncepteve bazë të fiziologjisë mjekësore</p> <p>-Fitimi i njohurive të mjaftueshme mbi kushtet fiziologjike në të cilat funksionon organizmi i njeriut</p> <p>-Njohja e fiziologjinë të organeve deri në nivelet subqelizore dhe molekulare</p> <p>-Kuptimi i funksionimin e trupit të njeriut nga modelet në praktikë</p>
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të	

nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata			
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>-Përdorimi i ligjeratave përmes sllajdeve -Mësimi interaktiv me studentët -Diskutimi përmes pyetjeve analitike -Prezentimi me seminare</p> <p>Mjetet: Librat referentë, punimet shkencore, projektori, modelet anatomike, tabela</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes analizës të angazhimit gjatë tërë semestrit/vitit akademik. Dy teste do të vlerësojnë njohuritë nga lëmia, ndërsa aktiviteti në vlerësimin përfundimtar do të përfshihet edhe aktiviteti në ligjerata dhe ushtrime.</p> <p>Sistemi i vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Testet 70% 2. Seminaret dhe angazhimi në ligjerata 20% 3. Angazhimi në ushtrime 5% 4. Vijueshmëria 5% 		
Literatura			
Literatura bazë:	Fiziologjia e Njeriut nga Artan Shkoza.		
Literatura shtesë:	Punimet shkencore në revistat ndërkombëtare nga lëmia e fiziologjisë.		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Fiziologji, transporti i materies në qelizë.
<i>Java e dytë:</i>	Indet e ngacmueshme (nervat)
<i>Java e tretë:</i>	Muskujt
<i>Java e katërt:</i>	Gjaku
<i>Java e pestë:</i>	Enët e gjakut
<i>Java e gjashtë:</i>	Zemra
<i>Java e shtatë:</i>	Sistemi repirator
<i>Java e tetë:</i>	Trakti gastrointestinal dhe metabolizmi
<i>Java e nëntë:</i>	Metabolizmi dhe mirëmbajtja e nxehtësisë
<i>Java e dhjetë:</i>	Sistemi i organeve të taitjes
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Sistemi endokrin
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Sistemi nervor qendror
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Shqisat (shqisa e të pamurit)
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Shqisat (shqisa e dëgjimit dhe shqisat tjera)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> -Përcjellja e rregullt e ligjeratave dhe ushtrimeve -Angazhimi aktiv në ligjerata dhe ushtrime -Përgaditja e seminareve dhe detyrave tjera -Pjesëmarrja në testim -Respektimi i rregullave të mirësjelljes (qetësia, ruajtja e pajisjeve, kthimi i pajisjeve, largimi nga salla me leje) -Ndalohet praktika e plagjiaturës

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë		
Titulli i lëndës:	Fiziologjia molekulare e sistemeve të organeve		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	2+1		
Vlera në kredi – ECTS:	4		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Driton Vela		
Detajet kontaktuese:	driton.vela@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Fiziologjia molekulare mirret me studimin e funksioneve jetësore në nivel molekular. Përmes kësaj discipline mjekësore sqarohen mekanizmat kryesorë të sinjalizimit kimik të cilat rregullojnë funksionimin e sistemeve të organeve		
Qëllimet e lëndës:			
	<p>-Lënda e Fiziologjisë molekulare të sistemeve të organeve ka për qëllim që studentëve të ju sigurojë njohuri të mjaftueshme mbi funksionin e molekulave të cilat kontrollojnë proceset jetësore te njeriu</p> <p>-Njohja e funksionimit të secilit organ në nivel molekular shërben për të kuptuar bazën e ndryshimeve patofiziologjike te sëmundjet</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	<p>-Njohja e substancave kimike të involuara në funksionimin e sistemeve të organeve</p> <p>-Fitimi i njohurive rreth interaksionit dhe mekanizmave të veprimit të molekulave të ndryshme të përfshira në proceset fiziologjike.</p> <p>-Zbatimi i njohurive nga fiziologjia molekulare përmes moduleve praktike</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata			
Ushtrime teorike/laboratorike			

Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:			
	-Përdorimi i ligjeratave përmes sllajdeve -Mësimi interaktiv me studentët -Diskutimi përmes pyetjeve analitike -Prezentimi me seminare Mjetet: Librat referentë, punimet shkencore, projektori, modelet anatomike, tabela		
Metodat e vlerësimit:			
	Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes analizës të angazhimit gjatë tërë semestrit/vitit akademik. Dy teste do të vlerësojnë njohuritë nga lëmia, ndërsa aktiviteti në vlerësimin përfundimtar do të përfshihet edhe aktiviteti në ligjerata dhe ushtrime. Sistemi i vlerësimit: 1.Testet 70% 2. Seminaret dhe angazhimi në ligjerata 20% 3. Angazhimi në ushtrime 5% 4. Vijueshmëria 5%		
Literatura			
Literatura bazë:	Medical Physiology. Walter Boron.		
Literatura shtesë:	Punimet shkencore në revistat ndërkombëtare nga lëmia e fiziologjisë molekulare.		

Plani i dizajnuar i mësimimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet

Java e parë:	Makinat molekulare dhe fiziologjia e njeriut
Java e dytë:	Molekulat dhe organelet qelizore
Java e tretë:	Fiziologjia molekulare e shqisës së të pamurit
Java e katërt:	Fiziologjia e shqisës së dëgjimit dhe shqisave tjera
Java e pestë:	Fiziologjia molekulare e neuroneve në sistemin nervor qendror
Java e gjashtë:	Molekulat e gjakut
Java e shtatë:	Molekulat e sistemit imunitar
Java e tetë:	Fiziologjia molekulare e zemrës dhe enëve të gjakut
Java e nëntë:	Fiziologjia molekulare e muskujve
Java e dhjetë:	Fiziologjia molekulare e traktit respirator
Java e njëmbëdhjetë:	Fiziologjia molekulare e traktit tretës
Java e dymbëdhjetë:	Fiziologjia molekulare e organeve të tajitjes
Java e trembëdhjetë:	Fiziologjia molekulare e gjëndrave endokrine
Java e katërmëdhjetë:	Fiziologjia molekulare e organeve riprodhuese
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> -Përcjellja e rregullt e ligjeratave dhe ushtrimeve -Angazhimi aktiv në ligjerata dhe ushtrime -Përgaditja e seminareve dhe detyrave tjera -Pjesëmarrja në testim -Respektimi i rregullave të mirësjelljes (qetësia, ruajtja e pajisjeve, kthimi i pajisjeve, largimi nga salla me leje) -Ndalohet praktika e plagjiaturës

SYLLABUS i Lëndës Gjenetikë Molekulare

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Biologji Molekulare
Titulli i lëndës:	Gjenetikë Molekulare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III-të, semestri veror(VI)
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E Martë, 16- 17 ³⁰
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Avdulla J. Alija, Prof. i rregullt Dr. Fisnik Asllani, asistent
Detajet kontaktuese:	Dhoma nr. 55, tel.: 038-249-872 lok. 225, e-mail.: avdulla.alija@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Gjenetika Molekulare trajton strukturën, funksionin, dhe rregullimin e molekulave të përfshirë në proceset e trashëgimisë - ADN, ARN dhe proteina si dhe mekanizmat molekularë të veprimit të gjeneve në prokariotët dhe eukariotët, duke përfshirë edhe diskutimet për strukturën e kromozomeve, replikimin, mutagjenezën, riparimin e ADN-së, mekanizmat rekombinues, transpozimin, transkripcionin dhe kontrollin e translacionit. Do të diskutohen edhe shumë nga aplikimet gjenetike dhe çështje tjera të ndërlidhura duke përfshirë inxhinieringun gjenetik, terapinë me gjene, eugjenikën, bioteknologjinë, si dhe teknikat e shumta molekulare duke përfshirë purifikimin e ADN-së, PCR dhe klonimin e gjeneve
Qëllimet e lëndës:	Të ofrohet studim e temave të Gjenetikës Molekulare me qëllim që studentët të kenë një bazë të njohurive në këtë fushë; Të zgjerohen dhe thellohen njohuritë në gjenetikë molekulare të sistemeve gjenetike eukariote, prokariote dhe virale; Të mësohen dhe aplikohen qasjet moderne të Gjenetikës Molekulare në problemet që studiohen.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti pritët që të ketë këto njohuri dhe shkathtësi: <ul style="list-style-type: none">• Përshkruan strukturën formimin dhe funksionimin e ADN, ARN dhe proteinave;• Kupton konceptet, terminologjinë dhe mekanizmat e gjenetikës molekulare;• Përdor qasjet kryesore eksperimentale bashkëkohore të përdorura në hulumtimet e gjenetikës molekulare;

	<ul style="list-style-type: none"> Analizon dhe interpreton te dhënat nga eksperimentet ne Gjenetike Molekulare 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5 javë	10
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiime,seminare	2	2 javë	4
Detyra të shtëpisë	1	10 javë	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10 javë	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	6	1 javë	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	/	10
Totali			135
Metodologjia e mësimdhënies:	Një ligjërata dhe një ushtrim teorik ose punë praktike laboratorike në javë në kuadër të të cilave do të zhvillohen bashkëbisedime grupore, seminare, dhe ushtrime teorike. Një pjesë e ushtrimeve do të jenë laboratorike.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Vijimi i rregullt, detyrat e shtëpisë dhe angazhime tjera 15% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> Krebs, J. E, Goldstein, E. S. and Kilpatrick, S. T.2018. Lewin's genes XII. Jones & Bartlett Learning. Alberts, B., Johnson A.D., Lewis, J., Morgan, D. Raff, M., Roberts, K. and Walter, P. 2014. Molecular Biology of the Cell. W. W. Norton & Company; Sixth edition. 		
Literatura shitesë:	1. Singer, M. and Berg, P (1991) Genes and		

	<p>Genomes – a changing perspective. University Science Books. Mill Valley, California.</p> <p>2. Watson, J. D., Hopkins, N. H., Roberts, J. H., Steitz, J. A., &Wiiner, A. M. (1987)Molecular Biology of the Gene. The Benjamin/Cummings Publishing Company, Inc. Menlo Park, California</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje – gjenetika molekulare
<i>Java e dytë:</i>	Acidet Nukleike
<i>Java e tretë:</i>	Kromatina. Kromosomet.
<i>Java e katërt:</i>	Replikimi i ADN-së. Rekombinimet
<i>Java e pestë:</i>	Mutacionet
<i>Java e gjashtë:</i>	Riparimi i ADN
<i>Java e shtatë:</i>	Transkripcioni. Translacioni
<i>Java e tetë:</i>	Rregullimi i aktivitetit gjenetik te prokariotat, <i>Vlerësimi i parë</i>
<i>Java e nëntë:</i>	Rregullimi i aktivitetit gjenetik te eukariotet.
<i>Java e dhjetë:</i>	Epigjenetika
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Elementet transposable, viruset tumorale dhe onkogjenet. Gjenetika e kancerit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Analiza molekulare gjenetike dhe bioteknologjia
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Gjenomika dhe Proteomika
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Klonimi. Bimët dhe shtazët transegjenike. Etika. <i>Vlerësimi i dytë</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Evolucioni Molekular

Java	Ushtrimi teorik apo puna praktike/laboratorike që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje- Laboratori i Gjenetikës
<i>Java e dytë:</i>	Acidet nukleike
<i>Java e tretë:</i>	Struktura e ADN-së
<i>Java e katërt:</i>	Replikimi i ADN-së dhe rekombinimet
<i>Java e pestë:</i>	Mutacionet e ADN-së
<i>Java e gjashtë:</i>	Mutatcionet dhe riparimi ADN-së
<i>Java e shtatë:</i>	Transkripcioni. Kodi gjenetik. Translacioni
<i>Java e tetë:</i>	Rregullimi i aktivitetit gjenetik te prokariotat. Operoni
<i>Java e nëntë:</i>	Rregullimi i aktivitetit gjenetike te eukariotat. Epigjenetika
<i>Java e dhjetë:</i>	Elementet transposable dhe mutacionet
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Testimi per mutagenitet
<i>Java e dymbëdhjete</i>	Detektimi i demtimit të ADN-së – Testi i Kometës
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Hartat e gjeneve. Hartat gjenetike. Hartat fizike.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Analiza e komplementimit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Teknikat e gjenetikës molekulare - PCR

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Sjelljet penguese në sallën e mësimit apo në laborator, janë të papranueshme.

SYLLABUS i Lëndës Gjenetikë

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Biologji Molekulare
Titulli i lëndës:	Gjenetikë
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i II-të, semestri veror (IV)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E Mërkurë, 11- 12 ³⁰
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Avdulla J. Alija, Prof. i rregullt Dr. Fisnik Asllani, asistent
Detajet kontaktuese:	Dhoma nr. 55, tel.: 038-249-872 lok. 225, e-mail.: avdulla.ali@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Zhvillimet shkencore të kohëve të fundit, e bëjnë Gjenetikën më rëndesi fundamentale për Biologjinë në tërësi. Ky kurs ofron mundësi për të kuptuar parimet dhe konceptet e Gjenetikës duke i kushtuar rëndësi të veçantë ligjeve të trashëgimisë, strukturës, funksionit dhe mutacioneve të gjeneve si dhe aspekteve etike të hulumtimeve gjenetike dhe aplikimeve të tyre. Në kuadër të kësaj lënde (në përputhje me objektivat e programit) trajtohen trashëgimia Mendeliane dhe jo-Mendeliane, gjenetika molekulare, citogjenetika, gjenetika e kancerit, gjenetika e populacionit, gjenetika kuantitative, gjenetika e sjelljes etj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e këtij kursi janë: Të kuptohen proceset gjenetike në nivel molekular, të qelizës dhe të populacionit; Të analizohen ndërrimet në materialin gjenetik dhe pasojat e këtyre ndërrimeve në organizma; Të zhvillohen teknika analitike për të përpiluar hartat kromozomike; Të kuptohen veçoritë e materialit trashëgues dhe mekanizmat e sintezës së proteinave; Të kuptohet natyra e veçorive kuantitative; Të analizohet predispozita gjenetike në paraqitjen e sëmundjeve të ndryshme; Të zhvillohen aftësi që të mbledhen, analizohen dhe prezentohen të dhënat e fituara nga eksperimentet gjenetike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti pritet që të ketë këto njohuri dhe shkathtësi: <ul style="list-style-type: none"> • Kupton proceset gjenetike në nivel molekular, të qelizës dhe të populacionit; • Përshkruan dhe analizon ndërrimet në materialin gjenetik dhe pasojat e këtyre

	nderrimeve ne organizma; <ul style="list-style-type: none"> • Përdor teknika analitike për të përpiluar hartat kromozomike; • Kupton natyrën e veçorive kuantitative; • Analizon predispozitat gjenetike ne paraqitjen e semundjeve te ndryshme; • Mbledh, analizon dhe prezenton të dhënat e fituara nga eksperimentet gjenetike 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45/semester
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30/semester
Punë praktike	/////	/////	////////
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10/semester
Ushtrime në teren	/////	/////	/////
Kollokfiime,seminare	2	5	10/semester
Detyra të shtëpisë	/////	/////	5/semester
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/////	////////	40/semester
Përgaditja përfundimtare për provim	////////	/////	5/semester
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6/semester
Projektet,prezentimet ,etj	2	5	10/semester
Totali			161/semester
Metodologjia e mësimdhënies:	Një ligjërata dhe një ushtrim teorik ose praktik/laboratorik në javë në kuadër të të cilave do të zhvillohen bashkë-bisedime grupore, seminare, dhe ushtrime numerike.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Vijimi i rregullt dhe angazhimi ne diskutime e seminare 15% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hoda, A. (2008) Gjenetika ,Tiranë 2. Marinkoviç, D.(1983) Gjenetika ,Prishtinë. 3. Pierce, B.A. (2018) Genetics Essentials: Concept and Connections, New York. 		
Literatura shtesë:	1. Ayala, F. J. and Kiger, J. A., 1984. Modern Genetics.		

	<p>The Benjamin/Cummings Publishing Company, Inc. Menlo Park, California.</p> <p>2. Griffiths, A. J. F., Miller, J. H., Suzuki, D. T., Lewontin, R. C., Gelbart, W. M., 2000. An Introduction to Genetic Analysis. W.H. Freeman and Company, New York.</p> <p>3. Russell, P. J., 1998. Genetics. The Benjamin/Cummings Publishing Company, Inc. Menlo Park, California.</p>
--	---

Plani i dizejnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje –Historiku dhe zhvillimi i gjenetikës
<i>Java e dytë:</i>	Ligjet themelore të trashëgimisë
<i>Java e tretë:</i>	Citogjenetika dhe determinimi i seksit
<i>Java e katërt:</i>	Ndërrimet në strukturë të kromozomeve
<i>Java e pestë:</i>	Krosingoveri dhe rekombinimi i gjeneve
<i>Java e gjashtë:</i>	Ndërrimet në numër të kromozomeve
<i>Java e shtatë:</i>	Trashëgimi jashtëbërthamor. <i>Vlerësimi i parë</i>
<i>Java e tetë:</i>	Baza molekulare e trashëgimisë. Replikimi dhe Transkripcioni
<i>Java e nëntë:</i>	Translacioni. Kodi gjenetik dhe sinteza e proteinave
<i>Java e dhjetë:</i>	Ekspresioni i gjeneve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Mutacionet e gjeneve. Elementet Transposable. Riparimi i ADN
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Analiza Molekulare Gjenetike dhe Bioteknologjia
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Gjenomika dhe proteomika. Gjenetika e kancerit
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Gjenetika e populacionit. <i>Vlerësimi i dytë</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Gjenetika kuantitative. Gjenetika e sjelljes.

Java	Ushtrimi teorik apo puna praktike/laboratorike që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Metodat statistikore ne Gjenetikë
<i>Java e dytë:</i>	Interaksionet e aleleve nga lokusi i njëjtë; dominimi, recesiviteti, kodominimi, trashëgimi intermediar
<i>Java e tretë:</i>	Interaksionet e aleleve nga lokuset e ndryshme; epistaza, komplementimi
<i>Java e katërt:</i>	Mitoza, Kromosomet
<i>Java e pestë:</i>	Kromosomet politene te D. Melanogaster
<i>Java e gjashtë:</i>	Krosingoveri, hartat e kromosomeve
<i>Java e shtatë:</i>	Ndërrimet në strukturë dhe numër të kromozomeve
<i>Java e tetë:</i>	Trupi i Barr-it
<i>Java e nëntë:</i>	Gjenetika molekulare; replikimi, transkripcioni, kodi gjenetik, translacioni
<i>Java e dhjetë:</i>	Gjenetika molekulare; mutacionet auktotrofe, rregullimi i aktivitetit gjenetik
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Gjenetika e humane; trungjet farefisnore

<i>Java e dymbëdhjete</i>	Imunogjenetika
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Gjenetika e popullacionit; llogaritja e frekuencës së aleleve
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Gjenetika e popullacionit; Faktoret që prishin ekuilibrin gjenetik
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Gjenetika kuantitative; trashëgimia e veçorive poligjenike

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Sjelljet penguese në sallën e mësimit apo në laborator, janë të papranueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Drejtimi: Biologji molekulare
Titulli i lëndës:	Histologji dhe histokimi
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i dytë, semestri i III
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Lulzim Millaku
Detajet kontaktuese:	Mob. 044 258 - 923 E-mail: lulzim.millaku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Programi i lëndës Histologji dhe histokimi i shërben studentëve për një formim të plotë dhe mbi baza shkencore në studimet bachelor në fushën e biologjisë molekulare. Nëpërmes këtij kursi studentet do të njohin me mirë qelizat dhe indet e organizmave duke përdorur teknika të ndryshme mikroskopike. Theks i veçantë do t'i kushtohet marrëdhënies strukturë-funksion në inde dhe organe të ndryshme dhe rolin e qelizave staminale në rigjenerimin e indeve.
Qëllimet e lëndës:	Konceptet e përgjithshme që jepen në këtë lëndë, paisin studentët me njohuri teorike dhe praktike të teknologjisë së përgatitjes së preparateve cito-histologjike për studime më të thelluara, si në nivel indor dhe qelizor.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje: <ol style="list-style-type: none">1. te kuptojnë se si bashkohen qelizat për të kryer funksione për të cilat janë të specializuara.2. si grupet e organizuara të qelizave (indeve) janë rregulluar për të formuar sistemet e organeve të trupit.3. të njohin dhe interpretojnë imazhet mikroskopike të indeve.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	5	10
Totali			120
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokviume, provime.		
Metodat e vlerësimit:			
	Mënyra e vlerësimit të dijës dhe dhënies së provimit: Vlerësimi përfundimtar paraqet shumën: Vlerësimit të parë intermedier; 30% Vlerësimit të dytë intermedier:20% Vijimit të rregullt dhe angazhimi në diskutime dhe seminare: 10% Provimit final me test ose me gojë: 40% Totali: 100 %		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. M. Ross, P. Wojciech. 2015. Histology: A Text and Atlas, with Correlated Cell and Molecular Biology, 7th Edition. Lippincott Williams & Wilkins. 2. B. Young et al. 2014. Wheater's Functional Histology, 6th ed., Elsevier. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Zh. Zekaj. Praktikum i Histoteknologjisë 2015-2016. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Indet Konceptet dhe klasifikimi
Java e dytë:	Indi eptitelial
Java e tretë:	Indi lidhor
Java e katërt:	Gjaku dhe elementet e tij
Java e pestë:	Indi muskolor
Java e gjashtë:	Indi nervor
Java e shtatë:	Sistemi kardiovaskular Vlerësimi i parë intermedier
Java e tetë:	Sistemi limfatik
Java e nëntë:	Sistemi respirator
Java e dhjetë:	Sistemi riprodhues mashkullor
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemi riprodhues femëror
Java e dymbëdhjetë:	Parimet e studimit histokimik të materialeve biologjike
Java e trembëdhjetë:	Protokollet histokimike të studimit
Java e katërmëdhjetë:	Mikroskopia Optike; Stereomikroskopia, Mikroskopi me fushë të ndriçuar, me Kontrast fazor, me fushë të errët.
Java e pesëmbëdhjetë:	Mikroskopia elektronike: Mikroskopi elektronik TEM, Mikroskopi elektronik SEM. Vlerësimi i dytë intermedier

Plani i dizajnuar i mësimit– Ushtrimet:	
Nr.	Ushtrimet laboratorike që do të zhvillohen
1.	Njohja me llojet e MO, Kontrast fazor dhe fluoreshencë
2.	Përgatitje e tretësirave fiksuese, inkluduese, ngjyruese, dehidratuese
3.	Matjet me okular mikrometër dhe me programe kompjuterike
4.	Përgatitje të preparateve të materialeve të gjalla bimore
5.	Përgatitja e preparateve për studimin e strukturave bërthamore (Mikronukleuse etj.)
6.	Studimi i indeksit mitotik
7.	Përgatitje të preparateve kromozomike nga meristemat e rrënjëzave
8.	Studimi citologjik i kromozomeve
9.	Teknikat citologjike të studimit të Aberacioneve kromozomike numerike në qelizave bimore: (poliploidi, aneuploidi, haploidi, etj).
10.	Teknikat e studimit të Aberacionet kromozomike strukturale: (këputjet, translokacionet)
11.	Teknikat histo-citologjike të studimit të Indeve riprodhues në bimët
12.	Përpunimi i materialit biologjik të gjallë
13.	Fiksimi dhe fiksuesit
14.	Ngjyrosja e preparateve të gjalla dhe të inkluduara në parafinë
15.	Ngjyrosja histo-citologjike e preparateve e inkluduara në erzinat

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe se punë seminarike.

Mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj..

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Drejtimi: Biologji molekulare
Titulli i lëndës:	Imunobiologji
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i dytë, semestri i IV
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Lulzim Millaku
Detajet kontaktuese:	Mob. 044 258 - 923 E-mail: lulzim.millaku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë përshkruhet roli i sistemit imun në ruajtjen e homeostazës së tërësishme të organizmit nga veprimi i antigjeneve, organizimi dhe funksionimi i sistemit imun te invertebrorët dhe vertebrorët si dhe përshkruhen mekanizmat qelizor dhe molekular të reaksionit si dhe bazës gjenetike të këtij reaksioni.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është fitimi i njohurive më të reja shkencore lidhur me rolin e sistemit imun në ruajtjen e homeostazës së tërësishme të organizmit nga veprimi i antigjeneve, organizimit dhe funksionimit të sistemit imun te invertebrorët dhe vertebrorët (e ulët dhe lartë). Theks i veçantë i kushtohet mekanizmave qelizor (mbrojtja qelizore) dhe molekulare (mbrojtja humorale) të imunitetit të lindur dhe fituar, përkatësisht reaksionit imun (primar dhe sekondarë) si dhe bazës gjenetike të këtij reaksioni.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të kuptoj: <ol style="list-style-type: none"> 1. Rolin e sistemit imun në ruajtjen e homeostazës së tërësishme të organizmit nga veprimi i antigjeneve. 2. Organizimin dhe funksionimin e sistemit imun te invertebrorët dhe vertebrorët. 3. Mekanizmat qelizor dhe molekular të imunitetit të lindur dhe fituar, përkatësisht

	reaksionit imun si dhe bazën gjenetike të këtij reaksioni.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësuesin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	5	10
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokviume, provime.		
Metodat e vlerësimit:	Mënyra e vlerësimit të dijës dhe dhënies së provimit: Vlerësimi përfundimtar paraqet shumën: Vlerësimit të parë intermedier; 30% Vlerësimit të dytë intermedier:20% Vijimit të rregullt dhe angazhimi në diskutime dhe seminare: 10% Provimit final me test ose me gojë: 40% Totali: 100 %		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. K. Murphy , C. Weaver. (2016). Janeway's Immunobiology. 9th. Edition. Garland Science. 2. Roitt, Ivan, Brustoff, Jonathan, Male, David (2001): Immunology. 6th ed. Mosby, Edinburgh, UK. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Klein Jan (1990): Immunology. Blackwell 		

	<p>Scientific Publications . Boston, Oxford, ondon, Edinburggh , Melbourne.</p> <p>4. Lika (Çekani) Mirela, Bërxfholi Kristaq (2010): Imunologjia. Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.</p>
--	--

Plani i dizejnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në imunobiologji <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi historik i imunobiologjisë
Java e dytë:	Antigjenet <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi biologjik i antigjeneve • Determinantet antigjenike (epitopet) • Haptenet
Java e tretë:	Filogjenia e sistemit imun <ul style="list-style-type: none"> • Filogjenia e sistemit imun te invertebrorët • Filogjenia e sistemit imun te vertebrorët
Java e katërt:	Principet themelore të organizimit dhe funksionimit të sistemit imun Organizimi dhe funksionimi i sistemit imun te invertebrorët Organizimi dhe funksionimi i sistemit imun te vertebrorët e ulët
Java e pestë:	Organizimi dhe funksionimi i sistemit imun te vertebrorët e lartë Organizimi i sistemit imun te vertebrorët e lartë <ul style="list-style-type: none"> • Organet dhe indet limfatike • Qelizat e sistemit imun • Mediatorët kimik të sistemit imun
Java e gjashtë:	Funksionimi i sistemit imun te vertebrorët e lartë Imuniteti i lindur (jo specifik) <ul style="list-style-type: none"> • Barriera mekanike • Qelizat që marrin pjesë në imunitetin e lindur (komponenta qelizore) • Mediatorët kimik që marrin pjesë në imunitetin e lindur (komponenta humorale) • Reaksioni inflamator (inflamacioni)
Java e shtatë:	Imuniteti i fituar (specifik- i adaptuar)

	<ul style="list-style-type: none"> • Imuniteti qelizor • Imuniteti humoral Vlerësimi i parë intermedier
Java e tetë:	Antittrupat <ul style="list-style-type: none"> • Struktura ndërtimore e antitrupave • Biosinteza e antitrupave
Java e nëntë:	Reaksioni antigjen –antitrup <ul style="list-style-type: none"> • Precipitimi • Aglutinimi • Reaksioni i lidhjes së komplimentit
Java e dhjetë:	Imunotoleranca <ul style="list-style-type: none"> • Toleranca e limfociteve T në antigjenet e veta • Toleranca e limfociteve B në antigjene të veta • Raporti imun në mes nënës dhe fetusit Autoimuniteti
Java e njëmbëdhjetë:	Hipersenzitiviteti <ul style="list-style-type: none"> • Tipi i I i hipersenzibilitetit • Tipi i II i hipersenzibilitetit • Tipi i III i hipersenzibilitetit • Tipi i IV i hipersenzibilitetit
Java e dymbëdhjetë:	Imunodeficienca <ul style="list-style-type: none"> • Imunodeficienca primare • Imunodeficienca sekondare <ul style="list-style-type: none"> ○ Sindromi i imunodeficiencës së fituar (SIDA)
Java e trembëdhjetë:	Veprimi i sistemit imun kundër viruseve, baktereve, kërpudhave dhe parazitëve
Java e katërbëdhjetë:	Imunobiologjia e transplantimit <ul style="list-style-type: none"> • Antigjenet histokompatibile • Antigjenet e eritrociteve
Java e pesëmbëdhjetë:	Imunobiologjia tumorale Vlerësimi i dytë intermedier
Plani i dizajnuar i mësimit– Ushtrimet:	
Nr.	Ushtrimet laboratorike që do të zhvillohen
1.	Teknikat imunologjike
2.	Reaksioni antigjen-antitrup
3.	Reaksioni i precipitimit
4.	Hemoaglutinimi

5.	Fiksimi i komplimentit
6.	Izolimi i antitropave
7.	Imunoprecipitimi
8.	Kromatografia me afinitet
9.	Prodhimi i antitropave monoklonal
10.	Prova për kompliment
11.	Prova për qarkullim të imunokompleksit
12.	Precipitimi i imunokompleksit
13	Imunokompleksi në sëmundjet autoimune
14	Izolimi i popullatës së limfociteve
15	Ndarja e limfociteve me Fikol isopatik

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe se punë seminarike
 Mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj..



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA

"HASAN PRISHTINA"

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

Departamenti i Biologjisë

Programi: Biologji Molekulare (Bsc.)

Formular për SYLLABUS të Lëndës; Kimia Organike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Titulli i lëndës:	Kimia Organike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I (Sem II)
Numri i orëve në javë:	2 + 1 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	FSHMN, sipas orarit të shpallur
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Ramiz Hoti
Të dhënat kontaktuese:	mob:+383 44 271068 e-mail: ramizhoti@yahoo.com ramiz.hoti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kimia organike studion përbërjen, vetitë dhe reaksionet e komponimeve të karbonit. Komponimet organike janë të rëndësishme së veçantë për shumë lëmi shkencore. Në radhë të parë ato janë bartës të proceseve jetësore në organizmat e gjallë. Gjithashtu edhe përdorimi i tyre për nevoja të ndryshme është jashtëzakonisht i gjerë. Shumica e produkteve të konsumit të përditshëm, lëndët e djegëshme, produktet ushqimore, barnat, preparatet e ndryshme, masat plastike e shumë të tjera janë me përbërje organike. Si të tilla ato gjejnë zbatim në shkencat mjekësore, farmakologjike, në agrikulturë, kozmetikë, në teknologji ushqimore, ndërtimtari e shumë lëmenj tjerë.
Qëllimet e lëndës:	Fokusi kryesor i kësaj lënde është studimi i strukturës së komponimeve organike dhe lidhmëria me vetitë e tyre. Studentët duhet të zgjerojnë dhe të thellojnë njohuritë nga Kimia organike duke përfillur intersin dhe nevojat e tyre për zhvillim akademik dhe profesional. Ata duhet të njohin përbërjen dhe vetive të komponimeve organike dhe për kuptimin e ligjshmërive të ndryshmeve të këtyre komponimeve që ndodhen në natyrë dhe atyre që përftohen në mënyrë sintetike. Të zhvillohet personaliteti i studentit në krijimin e shprehive dhe shkathësive për punë të pavarur

	eksperimentale, përdorimin e drejtë të substancave kimike, të pajisjeve laboratorike dhe të edukohen për ruajtjen e shëndetit të tyre dhe të mjedisit. Përmes këtij kursi, studentëve do t'u ofrohet informacion i mjaftueshëm për bazat e kimisë organike.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p><i>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të njohin përbërjen dhe strukturën e komponimeve organike. ▪ Të kuptojnë proceset e ndryshme kimike dhe të përshkruajnë zhvillimin e tyre.. ▪ Të zbatojnë rregullat për paraqitjen e formulave, barazimeve kimikë dhe ato të emërimit të komponimeve organike sipas Sistemit ndërkombëtar "IUPAC". ▪ Të Identifikojnë dhe klasifikojnë komponimet organike sipas vetive të tyre dhe grupeve funksionore. ▪ Të analizojnë përbërjen e komponimeve organike. ▪ Të sintetizojnë komponimet organike përmes reaksioneve kimike. ▪ Të vlerësojnë rëndësinë e komponimeve organike për nevoja të njerëzimit dhe ndikimin e tyre në ndotjen e mjedisit. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2 orë	2 x 15	30
Ushtrime laboratorike	2 orë	2 x 15	30
Kolokviume, seminare	1 orë	1 x 15	15
Kontaktet me msimëdhënës/konsultimet	1 orë	1 x 15	15
Koha e studimit vetenak të studentit (në bibliotekë ose shtëpi)	2 orë	2 x 15	30
Pregatitja përfundimtare për provim	5 orë /javë	5 x 5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	5 orë	1 x 5	5
Totali			150
Format e mësimëdhënies:	Leksione me mësim interaktiv, diskutime, biseda, projekte, ushtrime eksperimentale individuale e grupore, punime seminarike.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Për vlerësim të studentit do të merren të gjitha aktivitetet mësimore të studentit, duke pasë në konsideratë të gjitha aspektet e matshme të vlerësimit të dijes , të shkathtësive dhe qëndrimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pjesëmarrja aktive në leksione 10% ▪ Kryerja e ushtrimeve 15% ▪ Vlerësimi i testeve intermediare: 20% ▪ Punimet seminarike 15% ▪ Provimi final: (testi final, 30% + intervista, 10%) 40% ▪ Total: 100% 		

Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. K. P. Vollhard, N. E. Schore, Organic Chemistry, Structure and function (seventh ed.) H, <i>Freeman and Company</i>, USA, 2018 2. John McMurry, Organic Chemistry, (Eight ed.) Brooks/Cole Cengage Learning, Canada, Australia, JAPAN, Korea, Mexico, Singapore, Spain, United Kingdom, USA, 2012. 3. R. Hoti, Kimia Organike Laboratorike, Universiteti i Prishtinës & Libri shkollor, Prishtinë, 2020.
Literatura plotësuese:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Francis Carey and Robert Giuliano, Organic Chemistry, (tenth ed.) Mc. Graw Hill Higher Education, Boston, Madison, New York, San Francisco, Lisbon, London, Madrid, Mexico city, New Delhi, Santiago, Sydney, Taipei, Toronto, 2017. 2. Paula Yurkanis Bruice, Organic Chemistry, (Fourth Ed.), Prentice Hall, 2005.

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftim me planprogramin e lëndës dhe literaturën
Java e dytë:	<p>Hyrje në Kiminë Organike Vetitë e komponimeve organike, përcaktimi i formulave, analiza cilësore dhe sasiore, struktura, izomeria.</p> <p>Izomeria e komponimeve organike Llojet e izomerëve, izomeria strukturore, izomeria hapsinore, Izimeria gjeometrike, izomeria optike, komponimet hirale. Aktiviteti optik (enantiomerët, konfiguracioni, konformerët). Reaksionet organike (llojet dhe mekanizmi i tyre).</p>
Java e tretë:	<p>Klasifikimi i komponimeve organike, hidrokarburet Klasifikimi sipas strukturës dhe sipas grupeve funksionore. Hidrokarburet, klasifikimi (aciklike, ciklike, alifatike aromatike). Alkanet, struktura, nomenklatura, vetitë fizike e kimike, reaksionet e alkaneve.</p>
Java e katërt:	<p>Alkenet, alkinet dhe dienët Struktura, klasifikimi, nomenklatura, vetitë fizike e kimike, reaksionet e alkeneve, alkineve e dieneve.</p> <p>Hidrokarburet ciklike Cikloalkanet, cikloalkenet. Hidrokarburet aromatike, benzeni, struktura, vetitë, reaksionet, derivatet e benzenit, hidrokarburet aromatike poliunazore.</p>
Java e pestë:	<p>Komponimet organike me oksigjen</p> <p>Alkoolet Klasifikimi, vetitë, reaksionet.</p> <p>Fenolet dhe eteret Fenolet, klasifikimi, vetitë, reaksionet. Eteret, klasifikimi, nomenklatura, vetitë fizike e kimike.</p>

Java e gjashtë:	<p>Aldehidet dhe ketonet Aldehidet, struktura, vetitë dhe klasifikimi. Sinteza e aldehideve. Ketonet, struktura, vetitë dhe klasifikimi. Sinteza e ketoneve.</p> <p>Reaksionet e aldehideve dhe ketoneve Reaksionet karakteristike të aldehideve dhe ketoneve (Adicionimi nukleofil, oksidimi, reduktimi). Identifikimi spektrometrik i aldehideve dhe ketoneve.</p>
Java e shtatë:	<p>Acidet karboksilike Struktura, vetitë fizike e kimike. Sinteza dhe reaksionet karakteristike të acideve karboksilike (Reaksionet acido-bazike, përfitimi i derivateve të acideve; acil-halogjenureve, anhidruereve, amideve, esterifikimi, reduktimi). Identifikimi spektrometrik i acideve karboksilike.</p> <p>Derivatet e acideve karboksilike Acil-halogjenuret, anhidrueret e acideve, esteret, amidet. Struktura, vetitë fizike e kimike. Sinteza dhe reaksionet karakteristike të derivateve të acideve karboksilike (Reaksionet e shndërrimit të derivateve, hidroliza e tyre.</p>
Java e tetë:	<p>Komponimet organike që posedojnë azot, nitrokomponimet dhe aminat Nitrokomponimet, emërtimi, vetitë, struktura. Aminat, struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet.</p> <p>Komponimet heterociklike Komponimet heterociklike me bërthamë pesë- dhe gjashtëkëndëshe me një dhe me dy heteroatome).</p>
Java e nëntë:	<p>Lipidet Gliceridet, përhapja në natyrë, vetitë, përdorimi, hidroliza e yndyrave. Lipidet e përbëra (glikoproteidet, fosfolipidet, lipoproteidet. Metabolizmi i yndyrave.</p> <p>Terpenet dhe steroidet Vajërat eterike, struktura, klasifikimi, vetitë, izolimi. Struktura e steroideve, Vitaminat D, vetitë, reaksionet, acidet e tëmthit, hormonet steroidale, funksioni i tyre në organizëm.</p> <p>Vitaminat Struktura, vetitë, klasifikimi, funksioni në organizëm.</p>
Java e dhjetë:	<p>Karbohidratet Monosakaridet, struktura (vargu i hapur dhe struktura ciklike), reaksionet, përfaqësuesit.</p>
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Disakaridet dhe polisakaridet Disakaridet, vetitë, përfaqësuesit. Polisakaridet, përfaqësuesit, vetitë, përhapja, përdorimi. Metabolizmi i karbohidrateve.</p>
Java e dymbëdhjetë:	<p>Amino acidet Struktura, klasifikimi, vetitë, konfiguracioni, sintezat dhe reaksionet, metodat për darjen në amino-acideve. Metabolizmi i aminoacideve.</p> <p>Peptidet dhe proteinat Struktura, vetitë, sequenca e amino-acideve në vargun peptidik, sintezat dhe reaksionet. Proteinat, klasifikimi (proteinat e thjeshta dhe të përbëra), vetitë, metabolizmi dhe funksioni biologjik, denatyrimi.</p>

	Proteinat e përbëra (fosfoproteidet, glikoproteidet, lipoproteidet, nukleoproteidet).
Java e trembëdhjetë:	Acidet nukleike Nukleozidet, nukleotidet, përbërja, struktura, funksioni biologjik, , ADN dhe ARN.
Java e katërbëdhjetë:	Enzimmat Struktura, nomenklatura, klasifikimi, koenzimat, reaksionet enzimmatike, përcaktimi i aktivitetit enzimatik.
Java e pesëmbëdhjetë:	Punim seminarik Referim i studentëve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi në ligjërata dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt. Studentët duhet të sillen konform rregulltivave të Universitetit të Prishtinës dhe në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës. Për rregullat e veçanta dhe specifikat e organizimit të ligjëratave e ushtrimeve, studentët njoftohen nga profesori i lëndës dhe asistenti i tij.

Prishtinë
më 08. 10. 2022

Prof. Dr. Ramiz Hoti



Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore
Titulli i lëndës:	Kimia analitike
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Dytë (II/III)
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E martë 11:00 –12:00, Departamenti i kimisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr.sc. Jeton Halili
Detajet kontaktuese:	jeton.halili@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Objektivi i studimit të këtij kursi mësimor është që studentët të njihen me bazat teorike mbi: Rolin e kimisë analitike, hyrja në analizën kimike. Gabimet në analizën kimike. Trajtimi dhe vlerësimi i të dhënave statistikore. Metodatat gravimetrike (karakteristikat e precipitatit dhe reagjentëve, zbatimi i metodave gravimetrike). Përbërja kimike e tretësirave ujore dhe ekuilibri kimik. Metodatat vllimetrike (tretësirat standarde dhe llogaritjet në vëllimetri). Teoria e titullimeve acido-bazike (tretësira dhe indikatorët, lakoret e neutralizimit për acide dhe baza të forta, lakoret e neutralizimit për acide dhe baza të dobëta, tretësira pufetrike). Analiza vëllimetrike me precipitim me nitrat argjendi dhe titullimet kompleksometrike. Parimet themelore dhe zbatimi i titullimeve redoks. Metodatat potenciometrrike (elektrodat referente dhe indikatorë, potenciomtria direkte, titullimet potenciometrrike). Hyrje në metodatat spektrometrrike (instrumentet për spektrometrin optike) Spektrometria e absorbimit molekular (UV-Vis, IR). Spektroskopia e fluoreshencës molekulare. Spektroskopia atomike (absorbimi dhe emisioni). Hyrje në metodatat kromatografike. Gaz kromatografia (principet dhe aplikimi). Kromatografia e lëngët (principet dhe aplikimi)</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllim i këtij kursi është noftimi i studenteve lidhur përcaktimin e analitëve inorganik dhe organik, ndjeshmërin dhe selektivitetin e tyre, përbërjen cilësore dhe sasiore të tretësirave. Të krijoj lidhshmërinë në mes të njohurisë teorike dhe veprimeve laboratorike të cilat janë të domosdoshme për analizën kimike të pavarur, që të pajiset me njohuri e cila i ndihmon në orientimin e shpejt dhe të drejt për kryerjen në praktikë të veprimeve analitike. Të zhvillojnë njohurit bazë mbi parimet themelore të kimisë analitike instrumentale.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të: <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojnë gabimet personale, sistematike dhe të rastit . - Të zbatojnë llogaritjet bazike statistikore (mesatare , devijim standard etj). - Të shpjegojnë parimet e analizave gravimetrike . - Të shpjegojnë disocimin e acideve dhe bazave, hidrolizën dhe tretshmërinë e kripërave në tretësira ujore duke përdorur konstantat përkatëse të ekuilibrit. - Të llogaritsin pH e tretësirave ujore me përbërje kimike të ndryshme - Të dallojnë pikën ekuivalente dhe pikën përfundimtare të titrimit. Të përcakton standardin primar dhe sekondar - Të llogarisin sasinë e një analiti bazuar në të dhënat e matjeve gravimetrike dhe vëllimetrike. - Të shpjegojnë parimet e matjeve potenciometrike. - Të shpjegojnë ligjin e Beerit dhe të llogarisë sasinë e një analiti bazuar në matjet spektrometrike. - Të shpjegojnë metodat kromatografike për analizimin e mostrave komplekse dhe të interpretojë kromatogramet.
---	--

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,	2	3	6

kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet ,etj	2	5	10
Totali			150
Metodologjia e mësimit:	Ligjëratë, punë laboratorike, punë seminari dhe individuale.		
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi i parë:</i> 25% <i>Vlerësimi i dytë:</i> 30% <i>Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:</i> 5% <i>Vijimi i rregullt:</i> 5% <i>Provimi final:</i> 35% <i>Total:</i> 100% Vlerësimi final me note do të bëhet si vijon: 51%- 60% = 6 61% -70% = 7 71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Skoog /West/ Holler, Fundamentals of Analytical Chemistry. Sixth Edition 2. Mustafë R. Bacaj, Kimia Analitike I (KA-I) Prishtinë 2002		
Literatura shtesë:	1. Skoog /West/ Nieman, Principles of Instrumental Analyses. Fifth Edition. 2. Undergraduate Instrumental Analysis, Seventh Edition Hardcover – July 21, 2014, by James W. Robinson , Eileen Skelly Frame , George M. Frame II .		

Plani i dizajnuar i mësimit - Ligjëratat:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Roli i kimisë analitike, Gabimet në analizën kimike
<i>Java e dytë:</i>	Trajtimi dhe vlerësimi i të dhënave statistikore
<i>Java e tretë:</i>	Përbërja kimike e tretësirave ujore dhe ekuilibri kimik
<i>Java e katërt:</i>	Metodat vëllimetrike, teoria e titullimeve acido bazike
<i>Java e pestë:</i>	Metodat gravimetrike dhe zbatimi i tyre
<i>Java e gjashtë:</i>	Vlerësimi i parë intermediar
<i>Java e shtatë:</i>	Parimet themelore dhe zbatimi i titullimeve redoks

Java e tetë:	Metodat potenciometrike (elektrodat referente dhe indikatorë, potenciometria direkte, titullimet potenciometrike)
Java e nëntë:	Hyrje në metodat spektrometrike (instrumentet për spektrometrin optike) Spektrometria e absorbimit molekular (UV-Vis, IR).
Java e dhjetë:	Spektroskopia e fluoreshencës molekulare
Java e njëmbëdhjetë:	Spektroskopia atomike (absorbimi dhe emisioni)
Java e dymbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar
Java e trembëdhjetë:	Metodat për ndarje në kimi analitike, kromatografia
Java e katërbëdhjetë:	Kromatografia e gaztë dhe kromatografi e lëngët
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi përfundimtar
Përmbajtja laboratorike:	
Nr.	Një përzgjedhje (rreth 10) e eksperimenteve të mëposhtme do të kryhet në laborator.
1.	Laboratori i kimit analitike, masat e sigurisë, rregullat e sjelljes
2.	Ekuilibri kimik dhe llogaritja e përqendrimit të tretësirave
3.	Analiza cilësore e kationeve
4.	Analiza cilësore e anioneve
5.	<i>Acidet dhe bazat, tretësirat buferike, hidroliza e kriperave</i>
6.	<i>Tretshmëria dhe produkti i tretshmërisë, komplekset</i>
7.	Përcaktimi titrimetrik i klorureve me tretësirë standarde të AgNO ₃ (metoda Fajans);
8.	Përcaktimi titrimetrik i bromiteve me tretësirë standarde të AgNO ₃ (metoda Volhard).
9.	Përcaktimi i kalciumit dhe magnezit në përzierje me titrim kompleksometrik me EDTA.
10.	<i>Përcaktimi spektrofotometrik i KMnO₄.</i>
11.	Përcaktimi i acidit acetilsalicilik në produktet farmaceutike me spektroskopi IR.
12.	Potentiometri – Electrodat Jon - Selektive
13.	Përcaktimi i hekurit në produkte bimore me SAA
14.	Kromatografia në shtresë të hollë
15.	Analiza e pesticideve me GC-ECD

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Kursi mund të regjistrohet pas përfundimit të obligimeve nga lëndët e mëparshme në vitin e parë të studimit. Vijimi i rregullt i studentëve në ligjëratat dhe në ushtrime është i obligueshëm. Secili student duhet të përgatisë dhe të shkruajë raportin laboratorik plotësisht i pavarur. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve shkyçja e telefonave është e domosdoshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti i Kimisë (FShMN)
Titulli i lëndës:	Kimia e përgjithëshme dhe Inorganike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë (Semestri I-rë)
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Avni BERISHA
Detajet kontaktuese:	avni.berisha@uni-pr.edu, 048-120512
Përshkrimi i lëndës	<p>Moduli do të u prezentojë studentëve bazat e Kimisë së Përgjithëshme dhe Inorganike, përfshirë: vetitë fiziko-kimike të materjës, strukturën elektronike të atomit, llojet e reaksioneve kimike, lidhjet kimike, vetitë e tretësirave, reaksionet dhe ekuilibrin kimik, termokiminë, vetitë periodike të elementeve, elementet e grupeve kryesore të sistemit periodik të lementeve kimike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Objektivat e këtij moduli janë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Zhvillimi i njohurive adekuate rreth koncepteve bazë të kimisë,2. Zhvillimi i aftësive për të njohur e kuptuar pricipet dhe rregullat përkitazi zhvillimit të reaksioneve kimike3. Zhvillimi i aftësive për aplikimin praktike të kimisë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij moduli student do të aftësohet që të:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Sqarojë e dallojë vetitë fizike e kimike të materjës, si dhe ndryshimet e tilla fizike apo kimike në materje.2. Përshkruan strukturën elektronike të atomeve dhe parimet të cilat diktojnë konfiguracionin elektronik të elementeve.

	<p>3. Kuptojë llojet e ndryshme të reaksioneve kimike, lidhjet kimike dhe forcat ndër-molekulare.</p> <p>4. Kuptojë ligjet e gazeve.</p> <p>5. Definojë e kuptojë vetitë koligative të tretësirave,</p> <p>6. Përshkruan shpejtësinë e reaksioneve kimike e të kuptojë ekuilibrin kimik.</p> <p>7. Përshkruan karakteristikat e elementeve të grupeve kryesore të sistemit periodic të elementeve kimike.</p> <p>8. Të zgjedhë problemet numerike të kimisë.</p> <p>9. Kuptojë bazën teorike e të zotëroj zhvillimin e procedurave praktike eksperimentale të kimisë.</p>
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	13	39
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			176

Metodologjia e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Konceptet bazë do të jepen përmes prezentimit dhe teknikave tjera të ligjerimit. • Do të përdoret mësim i kombinuar – interaktiv • Përmes debatimit të problemeve do të arrihen në konkluzionet e sakta rreth
-------------------------------------	---

	<p>koncepteve të ndryshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të ketë projekte grupore: grupe fokusi, prezentim në grup. • Punim seminarik • Do të përdoren: libra, projektori, materiale të përgaditura paraprakisht nga profesori, etj.
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Vlerësimi mbështetet si në vijim:</i></p> <p><i>Testi I-rë vlerësues : 10 %</i></p> <p><i>Testi i II-të vlerësues: 10 %</i></p> <p><i>Detyrat e shtëpisë dhe angazhimet e tjera 6 %</i></p> <p><i>Vijueshmeria e rregullt 7 %</i></p> <p><i>Vlerësimi nga asistenti 7 %</i></p> <p><i>Provimi përfundimtar 60 %</i></p> <p><i>Total 100%</i></p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Martin Silberberg, Patricia Amateis: <i>Chemistry : the molecular nature of matter and change</i>, 9th edition, McGraw-Hill Education, 2 Penn Plaza, New York. 2021 2. The professor's teaching materials and lecture/slides; 3. I.Filipovic; S. Lipanovic; Kimia e përgjithshme/ Kimia Inorgaike (kapituj), (përkthim nga Xh. Ahmeti) Prishtinë, 1996.
Literatura shtesë:	<p>Chemistry, 11th edition by Raymond Chang and Kenneth A. Goldsby. McGraw-Hill Education; 11th edition (2012)</p> <p>Laboratory Manual for Principles of General Chemistry 10th Edition. Allan Beran, Wiley; 10th edition (2014)</p>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Definicionet bazë. Gjendjet aggregate të materjës. Vetitë e materjes dhe ndryshimet e saj. Rëndësia e energjisë në studimin e materjës. Disa njësi të rëndësishme të SI në kimi.
Java e dytë:	Komponentet e materjës. Elementet, komponimet dhe përzierjet: një vështrim atomik. Teoria atomike e Daltoni-it.

	Observimet të cilat shpjen në modelin e atomit. Teoria atomike sot. Elementet: vështrimi i parë mbi sistemin periodik.
Java e tretë:	Komponimet: hyrje në lidhjet kimike. Formulatat, emrat dhe masat. Moli. Formulatat molekulare.
Java e katërt:	Klasat e reaksioneve kimike. Përqendrimi i tretësirave dhe roli i ujit si tretës. Reaksionet e precipitimit. Reaksionet acido-bazike. Reaksionet redokse.
Java e pestë:	Vlerësimi i parë
Java e gjashtë:	Gazet dhe teoria kinetike-molekulare. Një vështrim mbi gjendjet e materjës. Ligji i gazeve.
Java e shtatë:	Termokimia: rrjedha e energjisë dhe ndryshimet kimike. Format e energjisë dhe ndër-shndërrimi i tyre. Kalorimetria.
Java e tetë:	Konfiguracioni elektronik dhe periodiciteti kimik. Sistemi periodic i elementeve kimike. Trendet në vetitë fiziko-kimike të elementeve.
Java e nëntë:	Modelet e lidhjeve kimike. Vetitë atomike dhe lidhjet kimike. Modeli i lidhjes jonike.
Java e dhjetë:	Modeli i lidhjes kovalente. Ndërmjet ekstremeve: elektronegativiteti dhe polariteti i lidhjeve kimike. Lidhja metalike. Forma e molekulave.
Java e njëmbëdhjetë:	Forcat intramolekulare: lëngjet, trupat e ngurtë dhe ndryshimet fazore. Llojet e forcave intermolekulare, Vetitë e lëngjeve. Veqantia e ujit. Gjendja e ngurtë: struktura, vetitë.
Java e dymbëdhjetë:	Vetitë e përzierjeve: tretësirat dhe koloidët. Llojet e tretësirave: Forcat intermolekulare dhe tretëshmeria. Forcat intermolekulare dhe makromolekulat biologjike.
Java e trembëdhjetë:	Trendet periodike tek grupet kryesore të elementeve. Elementet e periodës së 2-të. Grupi 1: Metalet Alkaline. Grupi 2: Metalet alkalino-tokësore. Grupi 13: Familja e Borit.
Java e katërbëdhjetë:	Grupi 14: Familja e Karbonit. Grupi 15: Familja e Azotit. Grupi 16: Familja e Oksigjenit. Grupi 17: Halogjenet.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt i studentëve në ligjërata është i dëshirueshëm (i obligueshëm 70%) kurse në ushtrime është i obligueshëm. Ardhja me kohë në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve shkyqja e telefonave është e domosdoshme.

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Programi: Biologji molekulare
Titulli i lëndës:	Kulturat e qelizave shtazore dhe bimore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2 (2 orë leksione +1 orë lab + 1 orë seminare)
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E martë dhe mërkure, ora: 10-12, FSHMN
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Kasum Letaj Prof. Asoc. Dr. Bekim Gashi
Detajet kontaktuese:	bekim.gashi@uni-pr.edu; cel: +386 49 600 850
Përshkrimi i lëndës	Kulturat e qelizave shtazore: përbërja bazike e medimeve ushqyese të kulturave qelizore dhe kushtet e kulturës. Kultura qelizore primare. Metodrat e kuantifikimit dhe karakterizimit të qelizave. Rritja e qelizave tumorale dhe normale dhe seneshenca. Metodrat e sinkronizimit të rritjes së qelizave. Fuzionimi dhe diferencimi i qelizave në kulturë. Kulturat e qelizave bimore: Kërkesat teknike laboratorike për kulturat in vitro. Kushtet për rritjen optimale të bimëve donatore. Përgatitjet e medimeve ushqyese Fitohormonet: grupet, ndikim në kulturën e indeve dhe efektet e tyre. Kultura e protoplasteve. Teknologjia e qelizës bimore. Kultura e qelizave dhe indeve. Mikroshumimi.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs siguron njohuri të nivelit fillestar për teorinë dhe praktikën e kulturës qelizore shtazore dhe bimore. Ky kurs do të zhvillojë aftësitë e të kuptuarit dhe aplikimet e kulturës së qelizave shtazore dhe bimore dhe si ato mund të kontribuojnë në qëndrueshmërinë globale. Gjithashtu do të zhvillojë aftësitë praktike të studentëve për të kultivuar me sukses qelizat e bimëve dhe shtazëve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë kushtet e rritjes në kulturën e qelizave shtazore • të lidhin teknikat bazë dhe proceset në kulturën qelizore me njohuritë e biologjisë së qelizës

	<ul style="list-style-type: none"> • aplikimin e teknikave të krijimit të kulturës së qelizave dhe manipulimit të qelizave në kulturë • të interpretojë dhe të bëjë konkluzione në lidhje me të dhënat e fituara nga puna eksperimentale gjatë ushtrimeve praktike • të shpjegojë mekanizmat rregulluese në proceset qelizore: rregullimin e ciklit qelizor, sinjalizimin, senescencën, apoptozën dhe lidhjen e tyre me përdorimin e teknikave praktike në kulturën qelizore • shpjegoj komponentët e ndryshëm të medimeve ushqyese të kulturës së qelizave bimore 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	7	14
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfieme,seminare	2	8	16
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	15	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	1	8	8
Totali	30	77	119
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator, konsultime, Seminare, detyra shtëpie, vlerësime, provime.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë (kolokvium): 15% Seminaret ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 70% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Masters J. R. W. (2000): Animal cell culture 3. iz. Oxford University Press, Oxford. 2. Valbona Sota dhe Efigjeni Kongjika: Kulturat Bimore Indore dhe Qelizore. Universiteti i Tiranës, Tiranë, Albania, 2013. 		

Literatura shtesë:	3. Butler M (2004): Animal cell culture & technology, 2. iz. Bios Scientific Publishers, London & New York.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
